



O njerëz
**po ju vjen një muaj
MADHËSHTOR DHE I BEKUAR**



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 03 (478)
Mars, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Ramazani, ftesë për meditim / Mehmet Disha

6 Agjëro, fresko trupin dhe shpirtin / Bujar Spahiu

8 Lajme / Aktivitete



12 Kur'ani, udhëheqje shpirtërore për të gjithë / Nuredin Nazarko

16 Mësime e porosi profetike për vlerat e Ramazanit / Hytbe e Profetit (a.s)

18 Ata që u bënë myslimanë me thirrjen për në islam

20 Nata më e begatë - Nata e Kadrit / Dorian Demetja

22 Gruaja myslimane shqiptare në ramazan / Fatma Karaj

24 Zoti ynë / Redaksia



26 Singëriteti dhe gjurma e tij në jetën e besimtarit / Alban Islami

28 Ç'përfitojmë nga agjërimi? / Haki Sharofi

30 Ramazan Subashi, mësuesi atdhetar dhe patriot / Ylli Subashi

34 30 Këshilla për 30 ditët e Ramazanit / Aisa Kokiqi

36 Agjërimi dhe përfitimet e tij shëndetësore / Eldores Sula

38 Fëmijët shkruajnë dhe këndojnë për muajin e bekuar të Ramazanit / Hysen Kobellari





R

FTESEË PËR MEDITIM
Ramazani

Me fillimin e Ramazanit rinovohen edhe një herë mendimet, frymëzohen ndjenjat, ndërsa mëshira në frekuenca të shumëllojshme shkon e bashkohet ku me ankthin e ku me shpresën, bashkohet e thellohet në shpirt. Po, me ardhjen e tij ngrihen të gjitha pengesat e arritjes për tek Allahu, të gjitha paudhësitë shkatërrohen.

Për shpirtrat që ndiejnë përherë etjen për mëshirë, Ramazani është si shiu që mbërrin në zemër të tokës, vadit gjithë qenien, nga koka te këmbët, ujit ndërgjegjet që kanë filluar të thahen, zbret deri në thellësitë e ndjenjave dhe e kthen vetëdijen njerëzore në një pllajë të gjelbëruar. Aq sa të gjithë këta shpirtra që përjetësohen me ngjyrimin e minutave të kësaj pjese të bekuar të kohës zgjohen ndaj thellësive të magjishme të ekzistencës dhe s'duan të ndahen më prej kësaj klime plot hijeshi.

Në këtë mënyrë, këta njerëz të përkohshëm arrijnë në gradën e qenieve të përjetshme, ndërsa çdo sjellje e tyre e programuar sipas shpirtit të tyre të adhurimit, arrin vlera ceremonish parajsore.

Gati çdo natë në Ramazan është shumë më e thellë se natët e tjera dhe me dimensione të përtejme; ndërsa ditët me atë maturinë dhe ngjyrat goditëse ndjehen si një atmosferë sinjifikuese e vullnetit dhe durimit.

Shpirtrat e agjërueshëm, sikur përgatiten çdo natë për një takim të ri, të emocionuar deri në ngazëllim, të sjellshëm në masë dhe të edukuar deri në habi, trokasin në dyert e mëshirës dhe shpresës. Në fytyrat e tyre shfaqen njëherësh modestia me seriozitetin, siguria me brengën, sundon të qenit që e mënjanon bindshëm të dukurit. Zemrat u rrahin me dashuri, para së gjithash për të Dashurin e vetëm të zemrës së tyre, e më pas, po për hir të Tij, për çka ai ka krijuar.

Sytë plot magji e të mbështeturve me gjithë zemër tek Allahu, pasqyrojnë një sërë thellësish prej së përtejmes dhe gati të gjithë këta sy shkëlqejnë me dritën e një bote të panjohur.

Kush të dojë, edhe në Ramazan madje, le të ulet e të ngrihet me smirë e urrejtje, kush të dojë të turbullohet përballë të vërtetave të besimit dhe Islamit, kush të dojë le të mallkojë dritën, kush të dojë t'i shpallë luftë mirënjohjes, tolerancës; ndërsa neve

Ramazani, me gjithë dritën dhe forcën magjepsëse që zotëron, na pëshpërit me zërin shpresëdhënës pasuritë tona shpirtërore, traditën tonë të hershme; na pëshpërit dhe shpirtrat tanë të uritur i ngop me sofrat e begata, ndërsa përballë shpirtave të errët, qëndron i hapur, dhe duke i shkrirë urrejtjet e armiqësitë vazhdon të na freskojë me flladin e Xhenetit.

Mbarë myslimanët, të rinj e të vjetër, gra e burra, të pasur e të varfër, të shëndetshëm e të sëmurë, drejtues e të drejtuar, nëpunës e tregtarë, vijnë e bashkohen në klimën zbutëse, formuese e të magjishme të Ramazanit... e me një përzemërsi, pastërti, ngrohtësi ndajnë së bashku një lumturi që vetëm krijesat qiellore e njohin. Madje, në të shumtën e rasteve, ai ka një ndikim të pabesueshëm edhe mbi masat e njerëzve që duken të paaftë, të mjerë e të shkretë. Është e pamundur të mbetesh indiferent përballë Ramazanit që përfshin çdo gjë!

Ramazani, sidomos zemrat e hapura ndaj pafundësisë, i magjeps aq shumë, i ndikon aq thellë saqë vetëm atë dëgjojnë, atë mendojnë dhe atë ëndërrojnë!

Për të vëmendshmit e këtij muaji, iftaret përmbushen me ndjenjën e adhurimit dhe thuajse bashkëngjiten me teravitë; syfyret ndërthuren me namazin e natës dhe marrin pjesë prej afrimit me Mëshirëplotin. Rrugët mbushen me udhëtarët e xhamive, faltoret oshtijnë si Qabeja me tekbiere; rrugët, pazaret sikur kthehen në faltore; dhe faltorja vete e shndërrohet në Qabe.

Çdo zë, çdo lëvizje, çdo hap dhe çdo veprimtari në këtë muaj, na kujton Ramazanin në mënyrën e vet. Ndërsa ne mundohemi ta përjetojmë atë thellë në gjokset tona, ai, me momentet më të zjarrta na dhuron dashuri, përkushtim dhe emocion, duke i ofruar shpresë e vullnet etjes së zemrës sonë, ai i rikthen gëzimin syve të përplotur dhe buzëqeshjen fytyrave të brengosura.

Për këtë, ne nuk duam aspak që Ramazani të largohet; ne nuk duam por, sikurse çdo gjë që vjen duhet të ikë kur t'i vijë koha, edhe ai, si një i ftuar gëzimsjellës vjen, e pasi qëndron njëfarë kohe, largohet...dhe pas tij, vjen Bajrami, si kurorëzuesi i vetëm i gjithë pasurive të këtij muaji magjepsës.

Agjëro, fresko trupin dhe shpirtin

Feja islame nëpërmjet institucioneve të saj ka trasuar rrugën e madhësisë e të dinjitetit njerëzor. Një nga këto institucione është agjërimi. Thënia e famshme e Profetit tonë Muhamed a.s.: "Agjëroni, që të jeni të shëndetshëm", nxjerr në pah vlerat kuruese të agjërimin. Frazja "do të jeni të shëndetshëm", paraqet formën maksimale kurative për agjëruesin, në favor të dy pjesëve përbërëse të njeriut: trupit dhe shpirtit.

Agjërimi si institucion fetar dhe si subjekt mjekësor, është aq i vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Që me shfaqjen në tokë të njeriut të parë, midis shumë detyrash përkundrejt Krijuesit të tij, ishte edhe agjërimi, që prej tij të kish dobi si trupi, ashtu edhe shpirti.

Mjekësia e sheh agjërimin të studiuar apo të aplikuar në shërbim të përmirësimit apo edhe të shërimit të disa sëmundjeve apo të sistemeve në përgjithësi.

"Njeriu është mjek i vetvetes", thotë babai i mjekësisë, Hipokrati. "Nëse trupi nuk është pastruar, sa më shumë ta ushqesh, aq më shumë e dëmton atë."

Në mjekësi agjërimi quhet dietë urie dhe ai që e përdori i pari si të tillë në Evropë ishte mjeku francez E. Dui, në vitin 1887. Ai rekomandonte uri terapi në dy lloje: pjesërisht dhe gjithë ditën, duke pirë vetëm ujë për 25-30 ditë. Në këtë mënyrë, kur nuk ushqehemi

nga goja, fillon të ushqyerit endogjen (i brendshëm) dhe trupi fillon të shfrytëzojë rezervat në mëlçi, muskuj, etj. Një terapi e tillë rekomandohej në rastet e sëmundjeve të lukthit, të zorrëve, të mënjanimin të lodhjeve fizike, të depresionit nervor, etj. Kështu, uria, armiku më i madh i njerëzve, bëhet njëkohësisht edhe miku më i madh i tyre, shërues i vërtetë.

Në terapi të tilla, organizmi shpenzon dhjamin dhe mbeturinat, kryesisht helmet e grumbulluara nga metabolizmi i parregullt, sëmundjet, ilaçet, etj. Bashkë me peshën e humbur nga uria, përmirësohet veprimi kardiovaskular, tensioni, humb aritmia dhe frymëmarrja e parregullt, forcohet tonusi i zemrës. Agjërimi si metodë e tillë kurimi u aplikua më vonë në shumë klinika mjekësore.

Edhe sot, agjërimi në mjekësi paraqet bashkëkohësi, përparimi dhe i tillë do të jetë sa të jetë bota, sidomos kur masa intelektuale botërore e këtij fillim shekulli po e vërteton me vetëdije rëndësinë e tij.

Por agjërimi, përveç ndikimit që ka në trupin e njeriut, ka edhe një pikësynim tjetër dhe që i shtrin vlerat e tij në drejtimin më të vërtetë, më cilësor të tij, atë të kurimit të shpirtit. Që në lashtësi e deri sot, njerëzimi ka menduar e ka kërkuar të kurojë e të lehtësojë edhe shpirtin, dhe këtë e ka kërkuar vetëm

nëpërmjet një qëllimi: braktisjen e brengave. Të gjithë njerëzit, përkundër dëshirave, kërkesave e qëllimeve të ndryshme, nuk bëjnë asnjë lëvizje dhe nuk flasin asnjë fjalë e që me të nuk synojnë të dëbojnë brengën nga vetja. Kur është fjala për këtë synim, është e nevojshme të thuhet se njerëzit e shikojnë atë në mënyra të ndryshme, secili nga pikëpamja e vet.

Ka njerëz që nuk besojnë, prandaj nuk mendojnë fare për shpirtin. Ka edhe të këqij që nuk dëshirojnë të mirën dhe të vërtetën. Ka që synojnë pasuri, ka që duan të mbeten të varfër, ka njerëz të urtë, të devotshëm, por ka edhe nga ata që nuk e çmojnë diturinë e mbesin në injorancë, sikurse shumica e botës së rëndomtë.

Këto janë mënyrat me të cilat njerëzit synojnë t'i dëbojnë brengat. Megjithatë, të ndarë në grupe, njerëzit synojnë të vijnë në një pikë graviteti: askush nuk e konsideron brengën të mirë dhe dëshiron ta largojë nga vetja. Këtë e kërkojnë të gjithë, edhe i padituri, edhe dijetari, edhe i miri, edhe i keqi. Por duke mos gjetur faktorin kryesor e të vërtetë për të gjithë, garojnë në planet e tyre. Ai që synon pasuri, kërkon të mos bjerë në brengën e varfërisë, ai që kërkon dituri, i ruhet brengës së të paditurit, ai që kërkon shoqëri, i largohet brengës që sjell vetmia. Disa nga këto brenga arrijmë t'i pakësojmë, disa të tjera na lindin, disa na kalojnë e disa na mbeten.

Synimi i vetëm dhe i vërtetë ku njeriu duhet të përqendrohet për largimin e brengave është feja. Feja në trajtën e vet të përkryer, paraqet të vërtetën, e cila është në harmoni të plotë me nevojat e shpirtit të njeriut dhe prirjet e tij. Në fenë islame një nga këto të vërteta është agjërimi.

Agjërimi, përveç se është sprovë trupore, është, para së gjithash, sprovë shpirtërore. Në Islam, agjërimi është kohë e jashtëzakonshme me dimensione meditimesh të mëdha, të cilat i adresohen shpirtit nëpërmjet dy rrugëve: humanizmit dhe devotshmërisë. E para reflektohet me dhënien e lëmoshës, si forma më e lartë e fisnikërisë në drejtim të përmbushjes së nevojave njerëzore. "O agjërues, mos shuaj vetëm etjen dhe urinë tënde, por shuaj edhe urinë dhe etjen e të tjerëve". Ky është akt i manifestimit publik të humanizmit. Ndërsa rruga e dytë, ajo e devotshmërisë, e arrin apogjeun e vet në dialogun me Allahun xh.sh. nëpërmjet zbatimit të udhëzimeve të Tij.

Vetëm agjërimi është institucion, me ligje, rregulla e këshilla, të cilat kanë si qëllim kryesor mjekimin e shpirtit të njeriut. Çdo njeri i arsyeshem nuk ndërmerr asnjë aksion, derisa nuk e kupton qëllimin e tij dhe nuk përcakton cakun e tij. Qëllimin e agjërimit e gjejmë në domosdoshmërinë e tij si mjekues i shpirtit, i mbështetur në devotshmërinë e abstenimit të atyre faktorëve, që sjellin brenga te njeriu.

Për agjërimin në Islam nuk mjafton që të vijë

vetëm ana pasive materiale, e cila shprehet nga përmbajtja, nga ajo që ushqehet. Agjërimi, para së gjithash, është veprim aktiv shpirtëror, me të cilin ai që e kryen, arrin cakun, të cilin ia ka caktuar vullneti i Allahut. Pra, vullneti i agjëruesit përputhet nëpërmjet devotshmërisë me vullnetin e Allahut.

Nëpërmjet rrugës së përkushtimit ndaj Allahut, zhvillohet mjekimi shpirtëror. Përkushtimi ndaj Tij është qëllimi i vërtetë i agjërimit, si abstenim ndaj të gjitha veprave, që te njeriu sjellin çorientim, degradim dhe afirmim jonjerëzor. Përkushtimi ndaj Allahut xh.sh., kjo vlerë e pamatur, i përket atij që kontrollon qëllimet e veta dhe e bën maksimalisht të pastër nga dëshirat, që sjellin dobësi.

Përkushtimi ndaj Allahut, që shprehet në këtë rast në agjërime, e frenon njeriun nga dëshirat dhe pasionet e ulëta, që sjellin tek ai vetëm brenga.

T'i braktisësh ato ka vetëm një mënyrë e ajo është të punuarit e të vepruarit në emër të Allahut. Këtë mundësi më së shumti na e jep agjërimi.

Nuk ka krijesë në tokë e në qiell, që të mos e adhurojë Zotin, edhe pse ne nuk e kuptojmë mënyrën e adhurimit të tyre, me përjashtim të një pjese të njerëzve, të cilët, të mashtruar prej kënaqësive të përkohshme të kësaj jete, qëndrojnë larg adhurimit të Zotit. Besimtarët agjërues janë krenarë e të gëzuar për arsye se janë inkuadruar në adhurim ndaj Krijuesit të tyre, i janë bashkuar rreshtave të të gjitha qenieve në ekzistencë, në adhurim.

Agjërimi si adhurim i përsosur në vlera, e bën njeriun të jetë i pajisur me virtyte të larta. Gjatë agjërimit, njeriu ndihet më bujar me shoqërinë, e sidomos me pjesën më të varfër të saj, sepse, duke agjëruar, ai e ndjen vetë në praktikë urinë dhe vuajtjet e saj, prandaj tregon gatishmëri në ndihmë të tyre.

Agjërimi nuk është vetëm një provë, që bën ndërrimin e praktikës së përditshme jetësore, por është edukim fiziko-shpirtëror, i cili edukon si mendjen dhe qëllimet e saj, ashtu dhe trupin e shpirtin në dobi të vetvetes e shoqërisë. Agjërimi është shprehja më e lartë e durimit, si metoda më e mirë për heqjen dorë nga epshi vetjak ndaj gjithë atyre elementeve që i sjellin dëm shoqërisë.

Agjërimi është kohë lufte për njeriun në emër të Zotit. Luftë kundër gjithë asaj që është e dëmshme e pa vlerë për veten dhe shoqërinë. Kryhet në emër dhe me emër të Zotit, sepse është veprim i fshehtë dhe i vetmi në të cilin nuk mund të ketë hipokrizi. Njeriu ose agjëron në emër të Zotit, ose nuk agjëron fare.

Ky është mësimi i Islamit në domethënien e tij të mirëfilltë.

Allahu thotë: "Agjëroni për Mua, Unë jam shpërblyesi i tij".



1


FORUMI I 3-TË NDËRKOMBËTAR HUMANITAR TË MBAJTUR NË RIJAD

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në Forumin e 3-të Ndërkombëtar Humanitar të mbajtur në Rijad, në datat 20-21 shkurt 2023.

Organizator i forumit ishte Qendra Mbreti Selman për Bamirësi dhe Ndhimë Humanitare. Kryetari Spahiu ishte i ftuar i posaçëm nga kreu i kësaj organizate z. Abdullah bin Abdulaziz al-Rabia.

Në këtë forum z. Spahiu zhvilloi takime me disa nga personalitetet më të rëndësishme politike, sociale dhe fetare në Arabinë Saudte, ndër ta, Shkëlqesia e Tij, Fajsal bin Ferhan Al Suud, Ministër i Jashtëm i Mbretërisë, Mbikqyrësi i Qendrës Mbreti Selman, etj.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është partner strategjik i Qendrës së mirënjohur në mbarë Lindjen e Mesme e cila është themeluar nga Hirësia e Tij, Mbreti Selman bin Abdulaziz, pasi prej mëse pesë vitesh rreth 25 mijë familje shqiptare të shtresave më në nevojë kanë përfituar ndihma dhe dhurata të ndryshme si shporta ushqimore, bursa shkollore etj.





2

VIZITË ZYRTARE E DELEGACIONIT NGA BASHKËSIA FETARE ISLAME E AUSTRISË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu priti në një vizitë zyrtare një delegacion nga Bashkësia Fetare Islame e Austrisë, delegacion ky i kryesuar nga Presidenti i Bashkësisë në fjalë, Mag. Umit Vural, Kryetari i Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë, z. Vahidin Behluli, si dhe dy përfaqësues të tjerë.

Pasi ju uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe pasi i falenderoi ata për vizitën, Kryetari Spahiu, i njohu shkurtimisht me historikun, organikën, si dhe me misionin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në shoqërinë tonë.

Ndërsa, z. Vural, nga ana e tij, e falenderoi Kryetarin Spahiu për mikpritjen dhe ndau me të një tablo të shkurtër përshkuese mbi institucionin që ai përfaqëson dhe veprimtarinë e tyre.

Gjatë kësaj vizite, ndërmjet palëve u nënshkrua edhe një memorandum bashkëpunimi, objekt i të cilit është forcimi dhe thellimi i marrëdhënieve ndër-institucionale në fusha me interes të përbashkët, për një afat 5-vjeçar.





3

THEMELIMI I KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR, NGJARJE HISTORIKE KOMBËTARE

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, me datë 24.02.2023, organizuan ekspozitën me temë: "Themelimi i Komunitetit Mysliman Shqiptar, ngjarje historike kombëtare", ekspozitë kjo e cila vjen për publikun e gjerë në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të institucionit.

Në ceremoninë hapëse të kësaj ekspozite që u zhvillua në hapësirën para xhamisë "Et'hem Beu", ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Drejtori i Arkivave të Përgjithshme të Shtetit, z. Ardit Bido, Drejtori i Kulturës pranë KMSH-së, z. Dorian Demetja, Myftiu i Tiranës, Lauren Luli, imamë, besimtarë dhe media të shumta.

Në fjalën e tij për mediat, Kryetari Spahiu, u ndal shkurtimisht në etapat më të rëndësishme të institucionit në këtë 100-vjetor. Ndërsa, z. Bido, theksoi rolin e klerikëve në historinë e shtetformimit tonë. Sipas tij, ata kanë një kontribut për tu vlerësuar në hedhjen e bazave të forta të kulturës, arsimit, dhe identitetit tonë kombëtar.

Pas fjalëve përshëndetëse për mediat e pranishme, ekspozita u hap edhe për publikun e gjerë, të cilët shprehën interes për ta vizituar dhe për tu njohur nga afër me zhvillimet kryesore të institucionit këto 100 vite.





4

100-VJET NGA THEMELIMI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË

Në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në ambientet e "Tirana International Hotel" u zhvillua aktiviteti i radhës me titull "100-vjet KMSH", ku ishin të pranishëm myftijtë e çdo qyteti, anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, imamë dhe kryesia e institucionit.

Ky takim u çel me leximin e disa ajeteve të Kuranit Famëlartë nga Drejtori i Arsimit e njëkohësisht imami i xhamisë "Et'hem Beu", z. Elton Karaj, më tej programi vijoi nën moderimin e Nënkrjetarit të KMSH-së, z. Taulant Bica.

Pasi bëri një rezymë të shkurtër rreth historikut të themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe i njohu të pranishmit me programin e aktivitetit, z. Bica, ia kaloi fjalën për përshëndetjen e rastit Kryetarit, H. Bujar Spahiu.

Në fjalën e tij, ai u ndal në sfidat kryesore që ka kaluar institucioni në këto 100 vite për të cekuar më pas edhe kontributin e gjithësecilit në mbarëvajtjen e aktivitetit fetar, kulturor e social në çdo myftini të vendit.

"Besimtarët myslimanë shqiptar kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në përcimin e mesazhit të bukur të islamit ndër vite dhe kanë qenë aktorë me rol të veçantë në çështjen kombëtare. Këtë kontribut e keni pasuar me shumë seriozitet edhe ju të nderuar myftij. Andaj, gjej rastin t'ju falenderoj përzemërsisht për punën tuaj të palodhshme në vazhdimësinë e misionit dhe vizionit të këtij institucioni" – u shpreh Kryetari Spahiu gjatë fjalës së tij.

Pas fjalës së kryetarit, të pranishmit ndoqën dokumentarin historik të përgatitur me rastin e këtij viti jubile.

Aktiviteti vijoi më tej në formën e diskutimeve të lira mes të pranishmëve.



Kur'anî,

UDHËHEQJE SHPIRTËRORE
PËR TË GJITHË



Kur njeriu planifikon për të bërë një udhëtim për në një shtet tjetër, së pari shikon hartën për të marrë udhëzimet e nevojshme, në mënyrë që të arrijë i sigurt në destinacion. Po kështu edhe myslimanët duhet ta konsiderojnë jetën si një rrugë për t'u ndërmarrë prej tyre. Çdonjëri nga ne është në një pikë në mes lindjes e vdekjes dhe të gjithë jemi në rrugën në mes krijimit e gjykimit, prandaj për këtë kemi nevojë për një hartë udhëzuese, një hartë që të na njohë e të na udhëzojë se në ç'drejtim duhet të udhëtojmë për të arritur në destinacion shëndoshë e mirë. Është vetëm udhëheqja hyjnore që na e tregon këtë rrugë të drejtë.

Përse duhet ta kemi këtë e jo diçka tjetër? Jeta është me shumë probleme të vështira; për ta përshkruar atë kemi nevojë për ndihmë. Qëllimi ynë final në jetë nuk është kalimi nëpër të, por përmbushja e disa detyrimeve, sa të jemi në këtë tokë, dhe kthimi te Zoti, "destinacioni" ynë në jetën pas vdekjes.

Përse duhet të ndjekim udhëheqjen hyjnore? Kur u pyet Daniel Webster se cili është mendimi më sublim që i shkonte nëpër mend, ai u përgjigj: "Përgjegjësia ndaj Zotit". E pra, ne jemi përgjegjës para Zotit për sjelljet e veprimet tona në këtë jetë. Jeta jonë mund të zgjasë nga pesë minuta e deri në disa vite apo disa dekada, por gjatë saj ne duhet të kemi parasysh përgjegjësinë ndaj vetes e familjes, shoqërisë e mbi të gjitha ndaj Zotit. Me zgjuarsinë e pafund dhe me mëshirën e plotë që Zoti ka, i ka komunikuar njeriut udhëzimet e Veta nëpërmjet profetëve në kohë të ndryshme. Urdhrat zbatuese të Tij kanë për qëllim që ta mbrojnë njeriun në këtë jetë të përkohshme nga të këqijat që herë pas here shfaqen dhe ta kthejnë të sigurt tek Ai në jetën pas vdekjes. Zoti në këtë mënyrë udhëhoqi Ibrahimin, Teuratin ia dërgoi Musait, Zeburin Daudit, Ungjillin Isait dhe Kur'anin Muhamedit a.s.

Kështu pra, Kur'ani është si një hartë rruge për të na udhëhequr me qëllim që të përmbushim detyrat e qëndrimit tonë në këtë jetë dhe për të fituar një vend të ndriçuar në jetën e pasosur.

Ç'është Kur'ani? Kur'ani është fjala e fundit e Zotit, dërguar Muhamedit a.s. nëpërmjet engjëllit Xhibril. Ky revelacion ka direktiva e udhëzime që kanë karakter universal dhe zbatohen në çdo kohë. Ai është pra përmbledhje e revelacioneve të

hershme. Është e vetmja kopje e plotë dhe autentike e fjalës së Zotit. Kopja e tij që përdorim sot, është e njëjta fjalë për fjalë, siç iu revelua profetit Muhamed a.s. nga Allahu 14 shekuj më parë, e pra nuk ka as shtesa, as ndryshime, as lënie jashtë, as tjetërsime në të.

Sa i rëndësishëm është Kur'ani i shenjtë për myslimanët?

Përderisa çdo fjalë e tij është nga Zoti, secila ka forcën dhe efektin e vet hyjnor. Prandaj Kur'ani ka një status të veçantë për myslimanët dhe është një epiqendër e Islamit. Ai na kujton qëllimin e vërtetë të detyrave që kemi, të shpërblimeve e të dënimeve që kemi, prandaj quhet edhe "mëshirë", "bekim", "lajmëtar", "paralajmërues". Myslimanët përdorin gjithën kohën e tyre duke e studiuar atë, duke e mësuar përmendësh, duke menduar për të, duke e zbatuar e vënë në jetë. Ata e lexojnë dhe e recitojnë atë, sepse është dëshira e tyre për të qenë afër Zotit nëpërmjet fjalës së Tij. Ata kërkojnë të fitojnë kënaqësinë e Tij duke zbatuar urdhrat që jep nëpërmjet Kur'anit. Nuk ka libër tjetër që të jetë mësuar krejt përmendësh si Kur'ani. Miliona myslimanë e dinë atë përmendësh.

Çfarë madhësie ka Kur'ani? Kur'ani, në gjuhën arabe, nuk është një libër shumë voluminoz. Ai është përkthyer në shumë gjuhë të botës, edhe në shqip. Kur'ani ka 114 sure (kapituj) nga të cilat më e shkurtra ka 3 versete (ajete) dhe më e gjata 286 ajete. Në këto 114 sure përmbahet urtësia supreme hyjnore, urtësi që shërben për të gjithë ata që kërkojnë të vërtetën, sepse vetë Kur'ani është universal. Ai është për ta lexuar çdo njeri; njerëz të zakonshëm, dijetarë, specialistë të degëve të ndryshme shkencore, njerëz të thjeshtë, të rinj, të moshuar, myslimanë e jomyslimanë. Ai i drejtohet të gjithë njerëzimit me këto fjalë: "O njerëz...". Kur'ani i kënaq të gjithë njerëzit me simfoninë e fjalëve të tij, me tregimet e tij, me bisdatat me karakter intelektual në përgjithësi. Kur'ani të tërheq me pasurinë e tij të pashtershme në çdo fushë, me kuptimet e tij të thella e me mendimet e tij.

Përse Kur'ani quhet një mrekulli e gjallë dhe e përjetshme? Bukuria e Kur'anit qëndron në stilin e tij lakonik. Fjalët e frazat në arabisht shprehin kuptimet më të pasura e më të forta në formën më të shkurtër. Fjalë për fjalë dhe frazë për frazë Kur'ani i lexuar,

thur së bashku, si një palë vargje, anën magjike në mendjen e njeriut. Leximi i tij ka një forcë të mrekullueshme dhe bukuri fonike; është brendia tërheqëse për mendjen, tingulli më i këndshëm për veshin. Një dijetar mysliman thotë: "Stili i Kur'anit është i fortë, emfatik si dhe i butë e delikat, sipas përmbajtjes. Lexuesi mund ta ndiejë atë të kumbojë si shkëmbinjte, si dhe butësinë e finesën e tij të pafund. Nëse leximi i Kur'anit mërmërit si një burim i qetë ose kumbon si një përrua, bukuria e tij është e pakrahasueshme. Ai buzëqesh dhe metaforat godasin imagjinatën me një forcë të madhe, që e lë tjetrin pa frymë dhe të bën për vetë".

Për arsye se ai është i vetëm dhe nuk mund të krahasohet ose të barazohet në bukuri e përsosmëri, Kur'ani nuk mund të hartohet nga mendja njerëzore, qoftë edhe nga një tubim i mendjeve më të shkëlqyera të botës në tërësi. Ai ka bukuri, madhështi, hir e një stil të vetëm që nuk gjendet gjë paralel me të.

Ç'lëndë e ç'subjekte trajton? Madhështia e larmia e tematikës së Kur'anit është unike. Asgjë nuk është lënë jashtë tij. Ai ka katër ndarje kryesore të subjekteve:

- Pjesët që urdhërojnë adhurimin e Zotit dhe të kujtuarit e krijimeve të bëra prej Tij. Këtu hyjnë parashikimet e të gjitha zbulimeve shkencore në fusha të ndryshme, si astronomi, fizikë, kimi, biologji, etj.

- Eskatologjia: Ringjallja, Dita e Gjykimit, shpërblimi e dënimi në jetën pas vdekjes.

- Histori e tregime rreth profetëve të hershëm. Kur'ani, si për të gjithë profetët, flet me nderim për Isain e nënën e tij, Merjemin, për të cilën një kapitull i tërë është emërtuar me emrin e saj, si një grua e dalluar mes të tjerave.

- Përmbajtje urdhrash e normash për mënyrën e trajtimit të punëve e çështjeve tokësore.

Kështu, Kur'ani përmban kodin e përgjithshëm të botës islame, atë shoqërore, tregtare, civile, ushtarake, gjyqësore, penale e fetare.

Zoti na tregon në Kur'an rreth natyrës njerëzore dhe se qëndrimi ideal i mendjes njerëzore është praktika dhe

arsyetimi. Kur'ani na mëson çlirimin nga kontradikta dhe paradoksi, i fton njerëzit të pranojnë mesazhin e tij me racionalitet, kritikë e pa dhunë. Ai thekson përdorimin e gjykimit personal. Kur'ani na jep kriterin për të dalluar të mirën e të keqen, na udhëheq të kërkojmë një bilanc në jetë. Nga ana shpirtërore ai na pastron shpirtin nga dëshirat e këqija dhe na përgatit për të hyrë në xhenet.

Ç'është impulsi i Kur'anit? Për ata që e dëgjuan Kur'anin të lexohej nga Profeti Muhamed a.s., ai ishte një realitet i gjallë dhe një forcë që ia mposhte krejt jetën. Ai ushtroi një forcë goditëse, tërheqëse. Ushtroi një pushtim shpirttrash, zemrash, mendjesh dhe vullnetin e tyre. Vetë recitimi i përpiu ata, duke e njohur origjinën e tij hyjnore dhe i nënshtroi me kushtet që iu shtroi revelacioni hyjnor. Kur'ani solli transformime në individë e në mbarë shoqërinë, në zemrat e besimtarëve. Ai krijoi një fazë të re mendimesh njerëzore dhe një tip të freskët të karakterit. "Ata që ndoqën këshillat e Librit të madh u bënë formësuesit e një qytetërimi që la gjurmët e veta të mrekullueshme deri më sot, duke i bërë drejtues të njerëzimit".

Kur'ani e ftoi njerëzimin në vepra të ndryshme dhe në shkencë, sepse vetëm me anë të kuptimit të krijimit të Zotit mund ta forcojmë besimin tonë në pushtetin e Tij suprem. Kështu, myslimanët mund të jenë njëherazi besimtarë dhe shkencëtarë, në mes të të cilëve nuk ekziston asnjë konflikt apo mosmarrëveshje.

Konkluzioni: Kur'ani është me të vërtetë një fenomen unik në historinë e kulturës njerëzore, e pra nuk është një libër sido kudo. Duke qenë fjala e Zotit, ai nuk mund të zëvendësohet me prodhime e vepra njerëzore. Ai është një thesar i çmueshëm dhe si i tillë respektohet nga të gjithë myslimanët. Është një libër për të gjithë kohërat, vendet, racat, një libër për të gjitha arsyetimet. Duke lexuar atë, njeriut i përftohet një zgjerim njohurish, ndërsa shpirtit të tij i sigurohet një shpërblim, kështu që, me plot gojën, mund të themi: "O Zot, Fjala Jote është e vërtetë."



Mësime e porosi profetike për vlerat e Ramazanit

Tregohet prej Selman Farisiut se Profeti Muhamed a.s. mbajti një hytbe në fund të muajit Shaban për rëndësinë e muajit Ramazan, ku, midis të tjerash, tha:

“O njerëz, po ju vjen një muaj i madh dhe i bekuar, në të cilin gjendet një natë më e mirë se njëmijë muaj. Është një muaj që Zoti e ka bërë farz (detyrim) agjërimin e ditës, namazet e teravive - namazet e natës në të – vullnetare. Çdo vepër e mirë në këtë muaj është e njëjtë me atë që ka kryer një farz jashtë këtij muaji, ndërsa ai që kryen një detyrë (domethënë një farz) në këtë muaj, është i barabartë me 70 farze, që i kryen jashtë këtij muaji. Ramazani është muaji i sabrit (durimit), kurse shpërblimi i sabrit është Xheneti. Ramazani është muaji i bamirësisë, muaj në të cilin shtohet bereqeti i besimtarit të vërtetë. Kush e fton tjetrin në iftar, do t'i falen gjynahet, do t'i shpëtojë zjarrit të Xhehenemit dhe do të ketë shpërblim të barabartë me atë që e ka ftuar në iftar pa asnjë pakësim të shpërblimeve të veta.”

Sahabet i thanë Profetit a.s. se disa prej tyre nuk kishin mundësi për këtë. I dërguari i Allahut u përgjigj: “Allahu do të shpërblejë me shpërblimin e përmendur çdokënd që e fton për iftar agjëruesin edhe me një hurmë, apo një gotë qumësht, ose qoftë edhe me një gotë ujë. Ky është një muaj, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi është falje, ndërsa fundi i tij është shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit. Në këtë muaj përpuni të plotësoni katër veti: me dy prej tyre do të kënaqni Allahun dhe dy të tjerat ju nevojiten juve. Të parat janë: Dëshmia e shehadetit, se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe lutje për të kërkuar falje prej të madhit Zot për mëkatet e bëra. Dy të tjerat janë: lutje për Zotin që të të shpërblejë me Xhenet dhe lutje që të të ruajë prej Xhehenemit. Kush e ushqen agjëruesin në këtë muaj, Allahu do t'i japë nga burimi i Vet, pas së cilit nuk do të ndiejë as etje, as uri, deri kur të hyjë në Xhenet. O popull, Ramazani

ju ka ardhur me bereqet e mëshirë për falje. Ky muaj është më i dashur për Allahun nga gjithë të tjerët. Orët e tij janë më të mira nga orët e tjera. Ky është një muaj në të cilin jeni të ftuar te Zoti në mikpritje, ku konsideroheni njerëz të mirë të Allahut xh.sh. Frymëmarrja juaj në këtë muaj është tesbih, gjumi është ibadet; puna juaj gjatë këtij muaji do të pranohet tek Allahu dhe lutja juaj do të plotësohet. Kërkoni nga Zoti juaj sinqerisht dhe me gjithë zemër që t'ju ndihmojë në agjërimin tuaj, të cilin jua ka bërë detyrë dhe lexoni Kur'anin që ju ka zbritur. I paaftë është ai që nuk përfiton në këtë muaj nga mëshira dhe falja e të madhit Zot. Derisa jeni të uritur e të etur, atëherë kujtoni urinë dhe etjen e Ditës së Gjykimit. Jepuni lëmoshë – sadaka – atyre që janë të varfër dhe pa përkrahje, nderoni më të vjetrit dhe kini mëshirë ndaj të rinjve, respektoni dhe vizitoni farefisin. Ulini sytë prej asaj që i ndalohet besimtarit ta shikojë dhe mos dëgjoni atë që besimtari e ka të ndaluar ta dëgjojë. Kini mëshirë ndaj të tjerëve, në mënyrë që Zoti të ketë mëshirë ndaj jush. Kërkoni prej Zotit që t'ju falë mëkatet. Ngrijini duart lart duke kërkuar prej Allahut me dua pas çdo namazi, se kjo është koha më e mirë për lutje dhe (për faktin se Allahu) i mbulon njerëzit e Vet me mëshirë dhe pranon duatë që i drejtohen. O popull, shpirtrat tuaj janë të varur prej veprave tuaja, çlironi shpirtrat duke kërkuar falje prej mëkateve. Shpirtrat tuaj janë ngarkuar me barrë të rëndë, lehtësojeni peshën me sexhde sa më të gjatë. Dijeni se Zoti nuk do t'i mendojë ata që falen dhe bëjnë sexhde dhe nuk do t'i frikësojë me zjarr të Xhehenemit. Kur të vijë nata e parë e Ramazanit një thirrës (prej anës së Zotit) thërret: O ti që kërkon mirësi, pranoi ato, dhe o ti që kërkon të liga, ndaloi. Shpëtimin nga zjarri i Xhehenemit e bën vetëm Allahu për çdo natë.”¹

1. Kjo hytbe paraqitet sipas rrëfimit të Ebu Hurejres.



ATA QË U BËNË MYSLIMANË ME THIRRJEN PËR NË ISLAM TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Ebu Bekri (r.a.) bëhet mysliman

Aishja (radjallahu anha) tregon: Një ditë, babai doli nga shtëpia dhe, me ç'dukej, do të shkonte pranë Krenarisë së Gjithësisë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Zaten kishin qenë miq shumë të mirë edhe para se të zbritet feja e Islamit. E njihnin shumë mirë njëri-tjetrin. Ebu Bekri shkoi pranë mikut të tij të vjetër dhe i tha:

- "O Ebu'l-Kasem, u bë kohë që nuk merr më pjesë në mbledhjet e popullit, të gjithë e kanë ndjerë mungesën tënde. Ata të akuzojnë ty se ti po përpiqesh të shkelësh e të përdhosësh të shkuarën tënde." Resulullahu u përgjigj:

- "Unë jam i Dërguari i Allahut, ndaj të ftoj edhe ty që të besosh tek Ai."

Një të mbaruar fjalët e të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekri (radjallahu anhu) u bë menjëherë mysliman. Resulullahu u kënaq aq shumë që Ebu Bekri u bë mysliman, sa që kur u largua prej tij, përreth të gjithë maleve që rrethojnë Mekën vështirë të kishte njeri më të gëzuar sesa i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

Profeti i profetëve ka thënë:

- "Kushdo që i kam bërë thirrje për në Islam, pa dyshim, që ka pasur një periudhë të lëkundjes dhe të pritjes, për t'u menduar njëherë. Por Ebu Bekri bën dallim nga të gjithë." Madje, i Dërguari i Allahut e pati vlerësuar si një kredi shumë të rëndësishme besimin e Ebu Bekrit pa u lëkundur, madje, një ditë, pati thënë:

- "Nuk ka dyshim, se Allahu më ka dërguar mua si profet. Kur unë jua shpalla juve këtë, ju të gjithë më thatë: 'Po na gënjen!' Vetëm Ebu Bekri më tha: 'Nuk ka dyshim që ti thua të drejtën!', dhe më ka ndihmuar me jetën dhe pasurinë e tij, mandej u pati përsëritur dy herë: 'Tani, ju nuk do ta mërzitni mikun tim, apo jo, e të ma lini mua?' - duke iu drejtuar njëherë të gjithë të pranishmëve përreth tij, e

më tej, duke iu drejtuar gjithë umetit të Tij.¹

Ebu Bekri (radjallahu anhu) u çua menjëherë së andejmi dhe shkoi pranë Osmanit, Talha bin Ubejdullahut, Zubejr bin Auamit dhe Sad bin Ebi Uakasit (radjallahu anhum) dhe u foli edhe atyre për ato që kishte dëgjuar me veshët e tij. Edhe ata u bënë menjëherë myslimanë, duke e pranuar thirrjen për në Islam. Ditën tjetër, Ebu Bekri pati shkuar tek Osman bin Madhuni, Ebu Ubejde bin Xherrahu, Abdurrahman bin Aafi, Ebu Seleme bin Abdulsesedi dhe Erkam bin Ebi'l-Erkami, që ishin gjithashtu ndër të parët që e kishin pranuar fenë islame, të cilët e pranuan po ashtu menjëherë ftesën e Ebu Bekrit të nderuar.²

Si u bë mysliman Omeri (r.a.)

Omeri (radjallahu anhu) u bë mysliman gjatë vitit të pestë a të gjashtë të profetësisë, kur ai ishte ende njëzet e gjashtë vjeç. Ndërsa, lidhur me pranimin e Islamit nga ana e tij, ka shumë transmetime të ndryshme.

Sklavi i Omerit (radjallahu anhu), Eslami tregon: "Omeri na pati pyetur:

- "A doni që t'ju tregoj se si jam bërë mysliman?"

- "Po!", - i thamë ne. Aty pati filluar të na tregonte:

- "Unë isha një ndër ata që ishin jashtëzakonisht të nxehur me Resulullahun. Një ditë, teksa ishim të ulur me parinë e kurejshëve, Ebu Xhehli na tha: 'O njerëz! Muhamedi po i shan të gjithë zotat tanë, madje na ka ofenduar duke thënë se mendja jonë është tejet e cekët dhe se të gjithë të parët tanë kanë shkuar në Xhehenem. Kushdo që e vret Muhamedin, prej meje do të marrë një shpërblim prej njëqind devesh të kuqe dhe të zeza, si edhe shumë para, me të cilat do të mund të bëjë një jetë madhështore.'"

1. Ibni Hisham, Sire 2/90.

2. Ibni Kethir, el-Bidaje 3/29.

Mandej, Omeri (radijallahu anhu) vijoi së na treguari:

- "Unë lidha menjëherë shpatën pas belit, mora pak ushqim me vete dhe dola nga shtëpia. Po shkoja të vrisja Profetin e Gjithësisë." Rrugës teksa ecte përballë i pati dalë kushëri i tij, Nuajm bin Abdullahu, i cili gjithashtu ishte bërë mysliman, por që e fshihte ende këtë fakt. Ky njeri iu drejtua Omerit (radijallahu anhu) dhe e pyeti:

- "Për ku po shkon kështu, o biri i Hatabit?"

- "Po shkoj të vras atë njeri që ka prishur unitetin dhe bashkimin e Kurejshëve, që na quan se nuk kemi mend, që përdhos fenë e të parëve tanë dhe nuk ka lënë fjalë të keqe pa thënë për zotat tanë.", – iu përgjigj Omeri.

- "Ta dish mirë, o Omer! Ti kështu nuk bën tjetër, veçse mashtron veten. Ti pandeh se kur të vrasësh Muhamedin, fisi i Adij bin Ka'bit (fisi i të Dërguarit të Allahut) do të të lejojë që të shëtitësh i lirë mbi tokë? Më lejo të të them diçka. Edhe familja jote dhe e kunatit tënd janë bërë myslimanë, duke të braktisur ty, edhe fenë tënde të trilluar.", – tha Nuajmi.

Aq iu desh Omerit (radijallahu anhu), dëgjoji këto fjalë të Nuajmit, nuk priti dot asnjë çast dhe e pyeti menjëherë:

- "E kush janë këta familjarë të mi?"

- "Kunati yt, djali i xhaxhait tënd, Said bin Zejd bin Omeri dhe motra jote, Fatime binti el-Hattabi."

Nuajmi e pati bërë gjithë këtë, që tregoi dy myslimanë të tjerë, për të shmangur si e si që Omeri (radijallahu anhu) të hiqte dorë nga qëllimi i tij për t'i bërë keq Krenarisë së Gjithësisë. Kur dëgjoji këto fjalë, Omeri frymën e mbajti drejt e në shtëpinë e motrës së tij. Nisi të trokiste në portën e tyre me vërtik. Në atë kohë, njëri prej sahabëve, që ishte i dashuruar pas të Dërguarit të Allahut, Habab bin Ereti (radijallahu anhu), po i mësonte motrës së Omerit (radijallahu anhu) suren "Taha". E motra, kur e pa Omerin, e dinte se ai mund t'u bënte keq, ndaj e fshehu menjëherë atë pjesë të Kur'anit që mbanin në duar. Kurse Hababi u fsheh në një cep të shtëpisë. Teksa po i afrohej shtëpisë, Omeri e pati dëgjuar se Hababi diç po u lexonte, ndaj, një të hyrë në shtëpi, pyetja e parë që bëri ishte:

- "Ç'ishin ato fjalë pa kuptim që këndonit, që i dëgjova teksa i afrohesha shtëpisë?"

- "Po bisedonim, ato mund t'i kesh dëgjuar, sepse ne nuk po këndonim asgjë.", – u përgjigjën ata.

Megjithatë, Omeri vijonte të këmbëngulte se kishte dëgjuar diçka krejt ndryshe.

- "Me ç'më kanë treguar, ju paskeni hyrë në fenë e Muhamedit.", – tha dhe u vërsul menjëherë mbi trupin e kunatit të tij, Saidit. Pavarësisht se e motra u përpoq të hynte mes tyre, për t'i ndarë, Omeri e pati rrahur atë, madje duke i lënë edhe plagë në trup. Pas kësaj, si e motra, ashtu edhe kunati, duke mbledhur një guxim të pashpjegueshëm brenda vetes, i thanë atij:

- "Po, myslimanë jemi bërë. Kemi besuar tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ja, kjo është e vërteta, ndaj tani mund të na bësh ç'ke për të na bërë!", – duke iu përgjigjur kësaj në një mënyrë që donin t'i tregonin se ata nuk i trembeshin më atij.

Omeri (radijallahu anhu), pa njollat e gjakut mbi trupin e së motrës dhe thellë brenda vetes ndjeu pendesë, ndaj dhe u tërhoq.

- "Ma sill edhe mua, ta lexoj njëherë atë që po lexonit pak më parë! Ta shoh njëherë, çfarë ju thotë juve kështu ky Muhamedi!" Omeri ishte njeri që dinte të lexonte dhe të shkruante shumë mirë. Këto fjalë e trembën shumë

motrën e tij, ndaj, e shqetësuar, ajo i tha atij:

- "Kemi frikë se ti do të na e prishësh atë që ishim duke lexuar."

- "Mos ki frikë.", – i tha Omeri, duke iu betuar se vetëm do ta lexonte dhe do t'ua kthente atë sërish.

E motra, kur e pa dëshirën e madhe që kishte Omeri për ta lexuar atë letër, duke shpresuar se mos bëhej edhe ai mysliman kur ta lexonte, ia dha, duke i thënë:

- "Vëlla i dashur, ti nuk mund ta prekësh atë, sepse tani ti je një prej idhujtarëve. Atë me dorë mund ta prekin vetëm ata që janë të pastër."

Aty, Omeri u çua dhe u la, mori gusul. E motra ia dha atë pjesë të Kur'anit në dorë. Omeri nisi ta lexonte. Kur mbaroi fillimin e sures "Taha", tha:

- "Ç'është kështu kjo fjalë, kaq e bukur dhe kaq e vyer!"

Kur pa se Omeri ishte zbutur ndjeshëm, Hababi doli nga ai vend ku po qëndronte i fshehur dhe i tha:

- "O Omer, të kesh besim tek unë, se unë kam shumë shpresë se lutja e të Dërguarit të Allahut për ty të pranohet, sepse dje, i Dërguari i Lartësuar i lut Allahut duke iu përgjjuar me këto fjalë:

- "O Zot! Lartësoje Islamin me Omer bin Hatabin ose Ebu'l-Hakem bin Hishamin."³ Për Zotin, nuk e di, por kjo më ngjan diç si një përkim i bekuar me lutjen e djeshme!"

Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër, kur Hababi tha fjalët e përmendura më sipër, Omeri i pati kërkuar atij që ta çonte atë menjëherë për tek i Dërguarit i Allahut, pasi donte edhe ai të bëhej mysliman. I Dërguari i Allahut, së bashku me një grup prej sahabëve të tij ishin duke qëndruar në një shtëpi në afërsi të kodrës së Safasë. Omeri shkoi drejt e te Krenaria e Gjithësisë (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Omeri kishte edhe shpatë në brez. Sahabët u trembën, kur e panë ashtu, të armatosur. Në atë kohë, atje gjendej edhe Hamzai (radijallahu anhu), i cili u tha:

- "Lëreni, le të vijë! Nëse ka ardhur me qëllim të mirë, atëherë ia japim atë që kërkon. Por, edhe nëse ka ardhur i nxitur nga qëllime të këqija, atëherë e vrasim me shpatën e vet." Kurse i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha:

- "Hapeni portën. Nëse Allahu do mbarësinë e Omerit, Ai mund ta shpjerë atë drejt udhëzimit"

Porta u hap. Dy sahabë e morën Omerin për krahësh dhe e prunë përballë Resulullahut.

- "Lëshojeni, lëreni të lirë.", – u tha i Dërguari i Allahut sahabëve të tij. Krenaria e Gjithësisë e priti Omerin në këmbë. E kapi me shpejtësi nga xhybeja e tij dhe i tha:

- "O Omer! Pse ke ardhur! Nuk dua të shoh që Allahu të zbrësë ajete përcmuese dhe poshtëruese edhe për ty."

- "O i Dërguari i Allahut! Kam ardhur për të dëshmuar e për të shpallur besimin tim. Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe, po ashtu, unë dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij." Veç kësaj, ai bërtiti:

- "Allahu Ekber". kur kuptuan se Omeri ishte bërë mysliman, sahabët që gjendeshin në atë shtëpi, zunë të thoshin të gjithë tek birë. Zëri kumbonjës i asaj shtëpie u dëgjua deri edhe nëpër rrugicat e Mekës.⁴

M. Jusuf Kandehleui

3. Ibni Kethir, el-Bidaje 3/80.

4. Ebu Nuajm, Hilje 1/41.



NATA MË E BEGATË

Nata e Kadrit

Nata në të cilën zbriti Kur'ani

"Ne e zbritëm atë (Kur'anin) Natën e Kadrit. E ku di ti ç'është Nata e Kadrit. Nata e Kadrit është më e dobishme se njëmijë muaj. Atë natë zbresin engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili) me lejen e Zotit të tyre për çdo çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit" (Kadr, 1-5).

Fjala "kadr" do të thotë "fuqi, sundim, nder, vlerë". Ky përgëzim hyjnor është aq i qartë dhe i fortë në Kuran, sa nuk lë vend për asnjë koment tjetër. Si rrjedhojë, ky është edhe një argument tepër i fuqishëm për vlerën e lartë të kësaj nate. Në një ajet tjetër Zoti Fuqiplotë përmend natën në të cilën është zbritur Kurani, duke thënë: "Ne ta zbritëm atë në një natë të bekuar. Ne deshëm t'u tërheqim vërejtjen, e njerëzit të jenë të gatshëm" (Duhan, 3).

Kur flasim për natën e Kadrit, duhet të parafytyrojmë një natë të qetë në muajin e Ramazanit, në të cilën

profeti Muhamedi a.s. meditonte i vetëm në shpellën Hira duke iu lutur Zotit që ta drejtonte dhe t'i tregonte rrugën e drejtë. Atë natë i zbriti kryeengjëlli Xhibril dhe kumtoi urdhrin: "Lexo me emrin e Zotit që të krijoj..." (Alak, 1-5). Allahu në këtë natë e zbriti Kuranin famëlartë nga Leuhi Mahfudhi (pllaka e ruajtur mirë tek i Madhi Zot) për në Bejtul Izeh, që është në qiellin e dynjasë. Kurani i Shenjtë pra, filloi t'i zbriste Pejgamberit natën e Kadrit dhe më pas sipas kohës dhe situatës vazhdoi t'i zbriste pjesë-pjesë për afro 23 vite. Kjo natë nderohet e çmohet për arsye se në të ka filluar të zbresë Kurani. Ata që e përcjellin Kuranin në gjokset e tyre dhe punojnë sipas tij do të jenë të nderuar e të shpëtuar ngaherë.

Nata më e vlefshme se njëmijë muaj

Kjo natë e madhe ka mirësitë e pakrahasueshme me asnjë natë tjetër të zakonshme, ngase vetë Zoti

nëpërmjet ajetit kuranor ka pohuar se kjo natë është më e mirë se njëmijë muaj (rreth 83 vjet). Në këtë natë zbresin engjëjt në qiellin e dynjasë, në tokë e rreth njerëzve, ashtu siç zbresin dhe kur njerëzit grumbullohen për të marrë dije të dobishme dhe për të lexuar Kuranin. Er-Ruhu është Xhibrili, i cili zbriti me Kuranin, kurse melekët e tjerë zbritën me të mirat e Allahut në tokë. Pra, me këtë ne nënkuptojmë se përveç Kuranit, melekët zbresin me detyrë të caktuar dhe secili prej tyre kryen misionin e vet, me të cilin është ngarkuar nga Krijuesi i Lartë.

Kjo natë karakterizohet nga një qetësi admiruese, njerëzit janë më të qetë dhe më të prirur për punë të mira. Në këtë natë nuk zbritet asgjë tjetër, përveç asaj që është mirësi dhe paqe. Nëse njerëzit do të zbatonin atë që ka zbritur në natën e Kadrit dhe do ta bënin program jete, atëherë në gjithë botën dhe gjithnjë do të mbizotëronte paqja, mëshira dhe begatia. Paqja zbriti natën e Kadrit, por janë njerëzit që nevojiten ta zbatojnë atë.

Koha e Natës së Kadrit

Koha e saktë dhe e prerë e natës së Kadrit nuk dihet. Allahu e ka fshehur këtë natë që robërit e Tij ta kërkojnë dhe të përpiqen me insistim për të kryer sa më shumë adhurime. Ebu Daud Tajalisi transmeton se Profeti a.s. ka thënë: "Nata e Kadrit është e ndritur dhe e paqme, pa ekstreme të nxehti ose të ftohti dhe të nesërmen në mëngjes, dielli lind me një shkëlqim të butë dhe si i kuq në ngjyrë."

Një ndër rrëfimet më të zgjeruara rreth kësaj teme na e përcjell sahabi i nderuar Ebu Said el-Hudri r.a.. Ai tregon: Pejgamberi bëri itikaf në dhjetë ditët e para të Ramazanit. Më pas në dhjetëditëshin e mesëm të muajit bëri itikaf nën një çadër të bërë me lëkurë dhie. Në vend të derës së çadrës ndodhej një hasër. I dërguari i Zotit a.s. e mori hasrën dhe e vendosi në një cep të çadrës. Më pas nxori kokën dhe iu drejtua njerëzve që ndodheshin në xhami. Populli u afrua nga ai. Ai i tha: "Unë, duke kërkuar natën e Kadrit bëra itikaf në dhjetëditëshin e parë. Më pas e vazhdova itikafin edhe në dhjetëditëshin e mesëm të muajit. Më erdhi engjëlli dhe më njoftoi se Nata e Kadrit ndodhet në dhjetëditëshin e fundit. Ata që kanë qenë në itikaf me mua deri tani, nëse duan, le ta vazhdojnë itikafin edhe në këto dhjetë të fundit" (Muslim, Sijam, 215). Prandaj në shumë vende myslimane besimtarët e devotshëm dhjetë netët e fundit të Ramazanit i kalojnë në xhami (itikaf) duke u falur e duke u lutur, si dhe duke kënduar e studiuar Kuranin, që kështu të jenë të gatshëm ta presin natën e Kadrit, që sipas fjalëve të Profetit duhet të jetë në netët teke të dhjetëditëshit të fundit të të Ramazanit. "...Ju kërkoheni atë në netët teke të dhjetë ditëve të fundit" (Muslim, Sijam, 212).

Nga sahabet e nderuar, Ubej bin Ka'b tregon se vëllai

i tij e ka rastisur Natën e Kadrit në natën e 27 të muajit, dhe e ka vërtetuar këtë duke u nisur nga shenjat që kishte dhënë Profeti a.s. rreth asaj nate (Muslim, Sijam, 220). Në përgjithësi disa sahabë dhe dijetarë myslimanë janë të mendimit se nata e Kadrit bie në natën e 27 të muajit të bekuar të Ramazanit dhe për këtë arsye e gjithë bota myslimane e nderon këtë natë në këtë datë.

Ashtu siç u vërejt edhe në hadithet e transmetuara, ka më shumë gjasa që Nata e Kadrit të jetë në netët teke të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit. Profeti a.s. duke iu dedikuar më shumë adhurimit këto dhjetë ditëve të fundit, duke porositur njerëzit drejt një adhurimi më të thellë, si dhe duke bërë personalisht itikaf në këto dhjetë ditë, e tregon më së miri këtë.

Vlerësimi i Natës së Kadrit

Kur Allahu me madhërinë e Tij i ka dhënë një rëndësi kaq të madhe kësaj nate, ne duhet medoemos të përgatitemi dhe ta presim atë me nderimet e merituar. Profeti a.s. në një hadith të tijin ka thënë: "Ai që e kalon Natën e Kadrit me adhurim duke besuar me zemër për vlerën e saj, i falen të gjitha gjynahet e mëparshme" (Buhari, Rijadus-Salihin, II, 464).

Le të përmendim disa adhurime me të cilat këshillohen besimtarët për vlerësimin sa më të mirë të kësaj nate:

1. Këtë natë duhen kryer adhurime për hir të Allahut, duhet falur namaz duke e përforcuar ndjenjën e adhurimit.

2. Duhet lexuar sa më shumë Kuran, të dëgjohet ai që e lexon atë si dhe të meditohet mbi ato ç'ka thotë Kurani.

3. Duhet të biem në salavat mbi Profetin tonë a.s., të shpresojmë në shefatin (ndërmjetësimin) e tij, të forcojmë vetëdijen e të qenit nga ymeti i tij dhe të rinovojmë besnikërinë ndaj tij.

4. Duhet të kërkojmë falje e mëshirë nga Allahu, të bëjmë vetëllogari dhe të bindim veten të kthehemi drejt rrugës së drejtë.

5. Të bëjmë sa më shumë dhikër (përkujtim) e të meditojmë. Vetëm me përkujtimin e Allahut gjejmë shpëtim dhe prehje zemrat.

6. Të lutemi sa më shumë, sepse duaja është mjeti që e afron më shumë robin me Zotin e tij. Transmetohet se Profeti ynë i nderuar a.s. në këtë natë e ka këshilluar Aishen të bëjë këtë dua: "Allahumme inneke afuuun, tuhibbu'!-afue fa'fu anni" {Zoti im! Ti je Falës, të pëlqen të falësh, më fal dhe mua!}.

7. Në këtë natë të shenjtë duhet të kërkojmë prej Allahut të falë të gjithë besimtarët. Të lutemi që kjo natë të bëhet faktor për forcimin e dashurisë dhe vëllazërisë, për bashkimin e botës islame dhe për ruajtjen e gjithë njerëzimit nga fatkeqësitë.

A young woman wearing a vibrant red hijab and a light blue apron over a white and red striped shirt is smiling warmly while chopping vegetables on a wooden cutting board. She is holding a large black knife. The cutting board is filled with fresh ingredients, including several bright red tomatoes, a white onion, and green leafy vegetables. The background is a clean, bright kitchen with white cabinetry.

GRUAJA MYSLIMANE SHQIPTARE NË RAMAZAN

Ramazani është një muaj i shumëpritur për çdo besimtar e besimtare, sepse është i veçantë dhe njeriut një herë në vit i jepet mundësia për ta jetuar. Nëse do të përqendrohemi dhe të mendojmë pak për rolin që kanë në ramazan gjyshet, nënat, bashkëshortet, motrat apo vajzat tona, do të shohim se ato, përveçse e presin me shumë mall, bëjnë përgatitje dhe planifikojnë që ky muaj të kalojë sa më mbarë.

Përgatitjet, kujdesi dhe mirësjellja e grave myslimane shqiptare e bëjnë më të veçantë këtë muaj duke sjellë aromë feste në shtëpitë tona.

Pa dyshim se me anë të të gjitha këtyre përgatitjeve, ajo përcjell te fëmijët përshtypje të jashtëzakonshme. Kjo bën që pas kalimit të këtij muaji, te pjesëtarët e familjes të krijohet menjëherë ndjenja e mallit për këtë atmosferë të bukur.

Nënat, duke i dhënë gjallëri, atmosferë festive dhe njëkohësisht shpirtërore ambienteve familjare, kanë lënë te fëmijët kujtime të pakrahasueshme, si dhe dëshirën që çdo muaj të jetë ramazan.

Gruaja përpiket t'i kushtojë një kujdes të veçantë këtij muaji dhe gjithashtu kujdeset të koordinojë punët si brenda ashtu dhe jashtë familjes, me qëllim që të përfitojë kohë edhe për adhurimet personale.

Ajo nuk e kalon të gjithë kohën e saj në kuzhinë. Edhe ajo shkon të falë namazin e teravive, lutet, lexon Kur'an dhe libra të ndryshëm, që flasin kryesisht për agjërimin, vlerat e tij, për mënyrën se si duhet shfrytëzuar sa më mirë kjo periudhë e artë, etj. Përmendja e vazhdueshme e Allahut gjatë gjithë ditës, duke ruajtur veten edhe nga mëkatet e gjuhës, është nga punët kryesore që ajo kryen me rigorozitet.

Ramazani i nxit besimtarët që të takohen më tepër me njëri-tjetrin, prandaj gratë organizojnë takime mes tyre, si biseda fetare, ku këmbëjnë me njëra-tjetrën njohuri dhe ide të ndryshme, organizojnë aktivitete bamirësie, ushqejnë nevojtarët, kujdesen për jetimët, etj. Kështu, ato nuk e neglizhojnë asnjëherë dimensionin social të këtij muaji.

Profeti a.s. thotë: "Asaj gruaje që fal pesë kohët e namazit, agjëron muajin e Ramazanit, ruan nderin dhe respekton burrin e saj, Ditën e Gjykimit do t'i thuhet:

"Hyr në Xhenet nga cila derë të duash".

Ajo është e ndërgjegjshme për vlerën e kohës, prandaj përpiket ta shfrytëzojë më tepër me vepra sesa me fjalë, më tepër me lot sinqeriteti, devotshmërie sesa me heshtje.

Profeti a.s., për vlerën dhe rëndësinë e kohës së agjëruetit gjatë Ramazanit, thotë: "Heshtja e agjëruetit është si përmendja e Allahut (tesbih), gjumi i tij është adhurim (ibadet), sikur të falë namaz, puna e tij shpërblehet shumëfish, ndërsa duaja e tij është e pranuar!"

Ramazani është muaji që e pasuron shumë kulturën e ushqimit dhe të pijeve. Kur vjen Ramazani, gruaja është ajo që menaxhon kuzhinën. Edhe burri sigurisht ka kontributin e vet. Të dy kanë detyra të ndryshme, prandaj dhe nuk mund t'i krahasojmë. Një rol të tillë vendimtar ato e kanë edhe gjatë Bajramit, sepse kur afrohet kjo festë ato sërish përgatisin dhe janë përgjegjëse për shtëpinë dhe familjen.

Obligimet dhe angazhimet e gruas gjatë Ramazanit shtohen, por pavarësisht kësaj, ajo nuk ndien aspak lodhje, por çdo ditë merr më shumë kënaqësi. Këtë e dëshmon fakti se, pavarësisht një muaji kaq intensiv edhe ajo e pret me padurim dhe me mall Ramazanin e vitit vijues.

Në veprat, fjalët dhe sjelljet e çdo gruaje shpaloset ndjenja e të qenët e dobishme brenda familjes, por edhe në shoqëri. Edhe gjatë këtij muaji figurën e gruas e gjejmë gjithmonë edhe më të dobishme, gjë e cila ndikon pozitivisht te fëmijët, të cilët rriten dhe edukohen me shembullin e nënës.

Gruaja myslimane me anë të gatimeve të saj, nuk ushqen vetëm familjarët, por edhe mysafirët, komshinjtë, nevojtarët. Ajo kërkon të solidarizohet me fjalët e të Dërguarit të Zotit, i cili thotë: "Ushqeni dikë gjatë Ramazanit, qoftë edhe me një hurmë". Kjo është një traditë e vyer, e cila duhet ruajtur dhe kultivuar.

Siç e shohim, gruaja gjatë gjithë kohës luan një rol shumë pozitiv në pritjen, përgatitjen dhe përcjelljen e këtij muajitë bekuar. Nga ana tjetër, Ramazani për të është një pikënisje për veprat e mira, si dhe për ripërtëritjen e rolit të saj të mrekullueshëm në gjithë spektrin jetësor, në lexim, të përkujtuarin e Allahut, lutje, edukim, etj.

Zoti YNË



Të gjitha falënderimet tona më të sinqerta të takojnë Ty, o Krijuesi ynë e Krijuesi i gjithësisë. Ty, që na ke nderuar me Islam; Ty që na ndriçove zemrat me iman; Ty që zbritte te ne më të madhërishmin libër hyjnor, të shenjtin Kur'an; Ty që na respektove me mëshirën tënde, duke na dhuruar edhe njëherë të mëshirshmin muaj, Ramazanin; Ty që na dërgove profet të dashurin Tënd dhe mësuesin tonë, Muhamed Mustafanë. Të kërkojmë falje dhe respekt për familjen e tij, për shokët dhe umetin e tij.

Zoti ynë, Ti që je i Vetëm dhe i Vërtetë, Ti që je Mëshiruesi dhe Bamirësi ynë, falënderimi ynë është për Ty, që na mundësove ta presim e ta jetojmë edhe njëherë muajin Tënd të mëshirës, Ramazanin.

Zoti ynë, të lutemi Ty, besimi ynë është i dobët, na e forco atë; morali ynë është i prishur, na e përmirëso atë; zemrat na janë nxirë, na i pastro ato; shpirtrat na janë zvogëluar, na i zmadho ato për hatrin Tënd.

Zoti ynë, na ndihmo, na udhëzo, na drejto në rrugën e përparimit e të prosperitetit njerëzor, në rrugën e

përmirësimit shpirtëror, moral, ekonomik e shoqëror.

Zoti ynë, në fillim të këtij muaji të madh, të lutemi me gjithë shpirt: mëshiroje, udhëzoje, drejtoje popullin tonë në rrugën e forcimit e të përparimit, dhuroi paqe e qetësi të përhershme.

Zoti ynë, për të gjitha sa t'u lutëm, kërkojmë prej Teje që të na i pranosh, sepse kështu ke premtuar dhe Ti nuk e shkel premtimin. Gjithashtu të kërkojmë falje e respekt për profetin tonë, Muhamedin a.s.; falje e respekt të kërkojmë për familjen e tij, për sahabet e tij, për umetin e tij. Falje e respekt të kërkojmë edhe për gjithë peygamberët, gjithë ulematë, gjithë myslimanët e myslimanet, ata që janë gjallë dhe ata që kanë ndërruar jetë me besim.

Sinqeriteti dhe gjurma e tij në jetën e *besimtarit*

Allahu i Lartësuar ka shpallur në Kur'an: "E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër përveç se të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë." (98:5)

"Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve, Ai nuk ka ortak. Kjo më është urdhëruar dhe unë jam ndër të parët myslimanë." (6:162-163)

"Ai është që ka krijuar vdekjen dhe jetën, që t'ju provojë se kush nga ju do të bëjë vepra më të mira." (67:2)

Fudejl ibën Ajad duke komentuar këtë ajet ka thënë: "Mendohet për veprat më të sinqerta dhe më të drejta"- I thanë: "Çfarë do të thotë më të drejtat dhe më të sinqertat?"- Tha: "Nëse vepra është e sinqertë dhe nuk është e drejtë, nuk do të jetë e pranuar tek Allahu xh.sh. E njëjta gjë, nëse është e drejtë dhe nuk është e sinqertë, sërish nuk do të jetë e pranuar. Do të jetë e pranuar vetëm atëherë kur të jetë edhe e sinqertë edhe e drejtë. Vepra e sinqertë është ajo e cila është kryer për hir të Allahut xh.sh., dhe është e drejtë kur kjo vepër është kryer ashtu siç e ka kryer i Dërguari a.s."

Pastaj ka lexuar ajetin vijues:

"Kush shpreson në takimin me Zotin e vet, le të bëjë punë të mira dhe duke adhuruar Zotin të mos i përshkruajë Atij askënd të barabartë." (18:110)

Çfarë është sinqeriteti ?

Përkufizimet e sinqeritetit të dijetarët myslimanë janë në kuptime të përafërta dhe shumica e tyre sillen rreth asaj se sinqeriteti është gjendja kur njeriu me adhurimin (punën) e tij nuk synon asgjë tjetër përveç kënaqësisë dhe shpërblimit të Allahut xh.sh. Do të shtojmë disa nga këto përkufizime:

Iz ibën Abdus-Selam ka thënë: "Sinqeriteti është që njeriu të zbatojë ato çfarë i është urdhëruar, pastërtisht për hir të Allahut xh.sh., dhe që me këtë të mos dëshirojë që njerëzit ta madhërojnë dhe nderojnë dhe as që të mos arrijë me të ndonjë përfitim në fe dhe as që me të të largojë nga vetja ndonjë fatkeqësi të kësaj bote."

Sehl ibën Abdullah ka thënë: "Sinqeriteti është që qëndrimi dhe lëvizja e njeriut të jenë vetëm për hir të Allahut xh.sh."

Fudejl ibën Ijad ka thënë: "Lënia e një vepre për hir të njerëzve është dukje (rija), ndërsa bërja e një vepre për hir të njerëzve është t'i përshkruash shok Allahut xh.sh. (shirk). Sinqeriteti është që Allahu të të ruajë dhe nga njëra dhe nga tjetra gjendje."

Vështirësia e sinqeritetit

Për të qenë të sinqertë në të gjitha veprat dhe fjalët, gjë për të cilën jemi të urdhëruar, është një nga vështirësitë me të cilat përballemi. Për këtë nuk mendohet vetëm për njerëzit mesatarë, të zakonshmit, por edhe për dijetarët dhe adhuruesit të cilët kanë treguar se është shumë e vështirë ta vësh në jetë dhe të ngjitesh deri tek shkalla e sinqeritetit, siç transmetohet nga muhadithi i madh, Sufjan eth-Theuri i cili ka thënë:

"Asgjë nuk ka qenë më e vështirë për mua sesa lufta me nijetin tim, i cili vazhdimisht ndryshon."

Për këtë i Dërguari i Allahut a.s. shpesh ka lexuar këtë lutje: "O Ti i Cili kthen zemrat, forcoje

zembrën time në fenë Tënde" (Tirmidhi: Da'vat; Ibën Maxhe: Efferat.) Gjithashtu tregohet se Profeti a.s. e kishte bërë zakon që të betohej kështu: "Jo, pasha Atë i Cili kthen zemrat." Zemrat janë të ndryshueshme në nijetet e tyre dhe në këmbënguljet e tyre. Ai i cili kërkon

të bindet për këtë, le të mbikëqyrë zemrën e vet për një kohë jo më shumë se një orë, dhe do të kuptojë se tani dëshiron këtë, pastaj atë, tani është e përqendruar për hir të Allahut në namaz, pastaj befasisht ndryshon për hir të një njeriu i cili po e shikon, në një çast me veprën e vet kërkon vetëm shpërblimin e Allahut dhe fill pas kësaj kërkon edhe shtesë nga kjo botë.

Sinqeriteti është i vështirë për atë se Allahu xh.sh. me urtësinë e Tij e ka bërë zemrën fushëbetejë ndërmjet shejtanit dhe engjëllit. Një çast e zotëron njëri, pastaj tjetri. Këtë më mirë na e ka sqaruar i Dërguari i Allahut a.s. kur ka thënë: "Në zemrën e birit të Ademit, dhe engjëlli dhe shejtani kanë pjesën (momentin) e vet. Gjatë kësaj kohe engjëlli e ngushëllon me mirësi dhe e frymëzon të besojë në atë çfarë Allahu xh.sh. i ka premtuar, ndërsa shejtani e frikëson me ligësi dhe e shtyn të kundërshtojë (të mos besojë) në atë çfarë Allahu xh.sh. ka premtuar." Dhe pas kësaj Pejgamberi a.s. ka lexuar ajetin: "Djali ju frikëson me varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të këqija, ndërsa Allahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati; Allahu është dhurues i madh, është i ditur." (2:268) (Tirmidhiu)

Ibën Kajjim në veprën e tij "Ilgathetul Leuhani", duke vështruar mbi këtë hadith, është shprehur:

"Engjëlli dhe shejtani shkëmbehen në zemrën e njeriut ashtu siç shkëmbehen nata me ditën. Ka njerëz tek të cilët dita është më e gjatë se nata e tyre (kjo do të thotë se prania e engjëllit është më e gjatë nga prania e shejtanit), ndërsa tek të tjerë njerëz ndodh e kundërta. Ka nga ata tek të cilët vazhdimisht është ditë (do të thotë se gjatë gjithë kohës ka praninë e engjëjve), dhe ka të tjerë tek të cilët ndodh e kundërta".

Pengesat në rrugën e sinqeritetit

Dijetarët myslimanë përmendin tre gjëra të cilat mundet më shumë të prishin ose të pengojnë në rrugën e sinqeritetit dhe këto janë:

- që njeriut t'i duket vepra e tij si e madhe;
- që njeriu të kërkojë shpërblimin e kësaj bote për veprën e tij;
- që njeriu të jetë i kënaqur për atë që ka bërë.

Ajo që ndihmon prej pengesës së parë është kthimi nga të mirat me të cilat Allahut xh.sh. e ka furnizuar atë, kthimi, në udhëzimin e Allahut dhe në vetëdijen se vepra e kryer është prej Allahut dhe jo prej tij (personit) dhe që kjo nuk është asgjë tjetër përveçse vullneti i Allahut xh.sh. ashtu siç thotë i Lartësuar i librin e tij: "Ju nuk mundeni, por vetëm nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve."(81:29)

Çdo vepër e mirë e jona që kryejmë nuk duhet ta shikojmë ndryshe përveçse si lëvizja e pemëve dhe fërfërima e erës, që do të thotë se pemët dhe era nuk do të kishin pikënisje për lëvizje, nëse dikush tjetër do t'i detyronte, siç edhe ne, që jemi në thelb të vdekshëm, nuk do të mund të zgjoheshim dhe nuk do të lëvizim po të mos ishte mirësia e Allahut ndaj nesh dhe po të mos qe vullneti dhe dëshira e Tij.

Në veten e njeriut ka padije dhe krenari, e prej natyre vetvetja (nefsi) është e ngathët dhe i jep përparësi pasioneve dhe gjërave të pavlerë. Burim i kësaj është edhe përvjedhja prej vështirësive. Si e tillë është e sigurt se nuk do të kishte mundësi të tregonte asnjë të mirë nëse nuk do të qe udhëzimi i Allahut xh.sh. për të.

Na mjafton si argument për të gjithë këtë që kemi thënë ajo që Allahu xh.sh. na thotë për robin e Tij më të zgjedhur Muhamedin a.s.: "Dhe sikur Ne të mos të kishim forcuar ty, ti gati anove diçka pak tek ta".

Ajo e cila ndihmon në kapërcimin e pengesës së tretë (dhe kjo është të qenit i kënaqur me veprën tënde) janë dy gjëra:

a- të kthyerit dhe të vështruarit në mangësitë apo tepritë e dëmshme në atë vepër, si edhe njohja e pamundësisë për ta mbajtur veprën larg ndikimit të shejtanit dhe dobësive të vetes.

Është pyetur Pejgamberi a.s. për shpërqendrimin e vështrimit të atij që fal namaz, e është përgjigjur: "Kjo është ajo pjesë të cilën shejtani arrin t'ia grabisë nga namazi." (Buhari).

Kur vetëm një vështrim i paqëllimtë i njeriut gjatë namazit, bie në atë pjesë që shejtani ia grabiti nga namazi, çfarë do të bëhej atëherë në kthimin e plotë të zemrës drejt dikujt tjetër përveç Allahut xh.sh.?

b- dija për atë çka Allahu xh.sh. urdhëron, në mënyrë që të jetë vërtetë i adhuroar; dija që njeriu është i dobët dhe i pamundur dhe larg përmbushjes së detyrës ndaj Allahut xh.sh. e pikërisht për këtë nuk guxon të jetë i kënaqur me veprën e vet dhe të druhet që të dalë përpara Allahut me atë vepër.

Disa thënie për sinqeritetin

Profeti Jakub a.s. ka thënë: "I sinqertë është ai njeri, i cili fsheh veprat e veta të mira në të njëjtën mënyrë siç fsheh veprat e këqija".

Profeti Ejub a.s. ka thënë: "Bërja e nijetit, për njerëzit e sinqertë, është më e vështirë se çdo vepër tjetër".

Përcaktimet për veprat që kryhen pa sinqeritet

Transmetohet nga një numër i madh dijetarësh myslimanë, që sinqeritetin e numërojnë si pjesë të pandashme të adhurimit, se adhurimi i kryer pa sinqeritet nuk është i vërtetë. Ashtu siç transmetohet nga Iz Ibn Abdus-Selam që ka thënë: "Sinqeriteti është kusht për adhurimin e vërtetë" (Kavaidul-Ahkam), ndërsa nga Kurtubiu transmetohet se ka thënë se sinqeriteti në adhurim është detyrë. (Tefsirul-Kurtubi)

Një qëndrim i tillë mbështetet në fjalët e Pejgamberit a.s.: "Allahu pranon vetëm ato vepra, të cilat janë të sinqerta, të kryera vetëm për hir të Tij dhe me të cilat kërkohet vetëm kënaqësia e Tij". (Nesai dhe Ebu Umame)

Lusim Allahun të na bëjë të sinqertë në fjalët tona, në veprat tona dhe të na pastrojë nga gjithçka që shemb sinqeritetin.

Ç'PËRFITOJMË NGA AGJËRIMI?

“Besimtarë, ju është bërë farz agjërimi në ditë të caktuara, si edhe popujve të kaluar, kështu që t’i shmangeni rrugës së prapë...”

Agjërimi në Islam ka tri shkallë: a) agjërimi i masës; b) agjërimi i inteligjencës fetare; c) agjërimi i të devotshmëve. Inteligjenca fetare agjëron duke mbrojtur nga mëkatet edhe veshët, sytë, gjuhën, duart, këmbët e çdo gjymtyrë të trupit. Të devotshmit agjërojnë duke fshirë nga zemra krejt qëllimet e liga, duke hequr dorë kryekëput nga punët e kësaj bote e duke lënë pas dore këtë jetë.

Dy shkallët e fundit mund të arrihen duke luftuar e zhdukur të gjitha epshet shtazarake e duke u përpjekur me veset e liga që të bëhet i zoti me sundu vetveten e me i çrrenjos këto vese. Mjeti i kësaj është vullneti i mirë, cilësi morale me të cilat shtypim lakmitë tona për çdo gjë që na dëmton pastërtinë morale.

Të rrallë fort janë ata që meritojnë me u numëruar të kësaj kategorie.

Pra, agjërimi, që është bërë farz për të gjitha klasat popullore, është ai i shkallës së parë: çdo mysliman e myslimane që shkel moshën madhore, janë të detyruar të agjërojnë në muajin e bekuar të Ramazanit, në të cilin, qysh në mëngjes e deri pas perëndimit të diellit, është e ndaluar ngrënia, pija e dëfrimi seksual.

(Ky klasifikim i agjërimit është formal e jo origjinal; sepse çdo mysliman e myslimane e ka detyrë që të përpiket ta kryejë këtë detyrë si duhet; por kur të mos mundet të arrijë shkallën e dytë e të tretë, së paku t’i mbahet shkallës së parë.)

Agjërimi është farz, me kusht që ta kryejnë pastaj përjashtohen përkohësisht nga ky farz ata, të cilëve u dëmton trupin; ata, agjërimi i të cilëve dëmton interesat publike; së fundi edhe ata që janë në udhëtim.

Dy janë qëllimet për të cilat Legjislatori na e ka bërë farz agjërimin: a) qëllim fizik ose shëndetësor; b) qëllim moral.

a) Agjërimi ka qëllime shëndetësore, pse nuk bën tjetër, veçse urdhëron zbatimin e porosive të shkencës shëndetësore: pushon dhe përmirëson stomakun, rregullon organizmin e përgjithshëm të trupit; të cilin e shëron dhe e shëndosh pa e dëmtuar fare. Ky është sekret i hadithit sherifit “Agjëroni, që të keni shëndet!” Për të mbërritur në këtë përfundim, si edhe për të larguar çdo dëm që rrjedh prej teprisë lakmuese të agjëruarit, që ka mbetur i uritur për shumë kohë, Pejgamberi a.s. ka urdhëruar këto masa:

- Shpejtimin e iftarit dhe vonimin e syfyrit.

- Më parë e çelim agjërimin me ndonjë ëmbëlsirë a me ndonjë pemë, pastaj falim akshamin, e mbas tij hamë darkë, sigurisht pa e tepruar.

- Një orë e gjysmë mbas darke falim Jacinë e mbas saj njëzet rekate teravi. Pa kryer këtë namaz nuk duhet fjetur.

- Pasi falet teravia duhet fjetur shpejt, pse ushqimet tjetërsohen në trup më shumë kur flemë. Kurrë nuk është e shëndetshme kalimi i këtyre netëve të Ramazanit pa gjumë, siç bëjnë shumica e njerëzve, që s’e çmojnë këtë pikë.

- Syfyri është sunet; edhe ky është ushqimi që do të hajë agjëruari disa minuta para mëngjesit, pa e tepruar.

- Sabahu duhet falur në kohë. Agjëruari në çdo kohë është i lirë të hajë e të pijë çdo gjë që e ka lejuar Zoti. Gjithashtu agjëruari ka leje për të plotësuar çdo dëshirë të arsyeshme që iu ndalua ditën.

Pra, Legjislatori ka urdhëruar agjërimin që të përmirësojë shëndetin e agjëruarit. Në statistikat e përgjithshme, që do të përmenden në rendin e vet, shihet se jetën më të gjatë në çdo cep të botës e kanë ata që agjërojnë.

Dobitë morale që rrjedhin nga efektet e agjërimin:

- E stërvit nefsine/egon t’u bëjë ballë dëshirave.

- Zengjinit i jep idenë e ndjenjës së urisë dhe e bën të kuptojë mjerimin dhe hidhësinë e të varfrit.

Më anë tjetër të vobektit e shohin me sy, se Perëndia shtrëngon zengjinët me një adhurim që ka për princip për të përmirësuar moralin e tyre, për t’iu zbutur zemrën e për t’iu dhënë shpirtin e bamirësisë, si edhe për t’iu shkullur apatinë, krenarinë e egoizmin.

- Njeriun e stërvit për t’i qëndruar urisë e etjes, në qoftë se ia sjell fati ndonjëherë mbi kokë.

- E bën njeriun të butë e të qetë: Sepse kur është i uritur dhe i etur, bëhet shumë i rreptë; çdo fjalë e rëndë, çdo sjellje e keqe agjëruarit i bën më shumë efekt. Por në këto minuta kritike, po ta sjellë ndërmend urdhrin e Resullullahut “agjëroj, agjëroj”, do t’i ftohen ndjenjat e do t’i zbutet zemra.

- E bën njeriun besnik e të sinqertë dhe e largon nga hipokrizia. Kjo sepse agjërimi është një adhurim i fshehtë dhe nuk shfaqet me lëvizje trupore. Prandaj është një sekret në mes të Perëndisë e robit. Është një hadithi kudsij që e forcon këtë të vërtetë, në të cilin thuhet: “Agjërimi është për Mua, vetëm Unë kam për ta shpërblyer çmimin e tij”.

- Njeriu është i ndaluar nga të gjitha epshet trupore e në këtë mënyrë zhvishet nga cilësitë shtazore dhe hyn në kategorinë shpirtërore e barazohet me engjëjt në një kohë të caktuar për çdo vit.

Nga sa thamë më sipër, merret vesh se agjërimi në fenë islame ka dy qëllime: një trupor e një moral.

Veç kësaj, agjërimi në Islam është një mjet propagandues për të prapësuar e për të çrrenjosur veset e liga e për të pastruar zemrën nga mikrobet që shkaktojnë këto sëmundje morale. Me të vërtetë agjërimi ndalon gojën nga fjalët e ndyra, ndalon syrin, dorën e këmbën nga veprat e panjerëzishme, pastron mendjen nga idetë e poshtra, e zbut zemrën dhe e shkëlqen shpirtin me dritën hyjnore.



RAMAZAN SUBASHI

Mësuesi atdhetar dhe patriot

Ramazan Subashi lindi në fshatin Marikaj të Tiranës më 12 shkurt 1893, në një familje me tradita atdhetare dhe fetare. Me ndërhyrjen dashamirëse të disa miqve, babai i tij, Sadik Subashi, e dërgon djalin e tij Ramazanin rreth moshës 20 vjeçare në Tiranë për të përvetësuar arsimin fillor në gjuhën shqipe te mësuesi patriot tiranas Hasan Vogli. Ky, duke parë zgjuarsinë, sjelljen dhe talentin në mësimin e gjuhës shqipe, e mban për disa vite në shtëpinë e tij. Krahas mësimin dhe njohurive të gjuhës dhe të shkruarit shqip, Ramazani tashmë në moshën 23 vjeçare, në vitin 1915 përfundon edhe gjimnazin turk të asaj kohe në Tiranë ku mësoi edhe gjuhën turke dhe arabe. I pajisur me njohuritë e fituara në gjimnazin turk dhe ato mbi shkrimin dhe gjuhën shqipe të marra te mësuesi patriot Hasan Vogli, në vitin 1916 kthehet në fshatin e tij të lindjes. Këtu fillon edhe momenti kulmor në jetën e këtij djaloshi të ri që kulmon në tre drejtime kryesore: drejtimi i parë padyshim ishte përhapja e mësimin dhe të shkruarit të gjuhës shqipe sipas ideve të rilindësve tanë. Drejtimi i dytë ishte veprimtaria si një prijës dhe predikues i fesë islame në trevën Marikaj, Vorë e deri në Shijak. Drejtimin e tretë të Ramazanit do ta shohim në rolin e një drejtuesi të aftë, të një patrioti dhe atdhetari të zotin.

Duke filluar me përhapjen e arsimit dhe të gjuhës shqipe, vërejmë se në momentin që Ramazani kthehet në fshatin e tij, kishte filluar një lëvizje për përhapjen e gjuhës shqipe, ku rëndësi e veçantë i kushtohej hapjes së shkollave fillore në gjuhën shqipe. Drejtorja e përgjithshme e arsimit e asaj kohe me drejtor Luigj Gurakuqin arriti të hapë gjatë periudhës 1916-1918, një sasi të konsiderueshme shkollash të arsimit fillor 3 klasësh nëpër fshatra. Në këtë situatë, me kërkesën e vazhdueshme të banorëve, si dhe me përkrahjen e nënprefektit të Durrësit Hamit bej Toptani, i cili zotëronte një pjesë të tokave të fshatit Marikaj, por dhe si fshati me numrin më të madh të banorëve dhe me një vend të përshtatshëm, me vendim të Prefekturës së Durrësit, më 10 tetor 1916, në fshatin Marikaj hapet shkolla e parë shqipe për trevën e sotme të Vorës. Kjo datë shënoi fillimin e të mësuarit shqip për banorët e fshatit Marikaj, por edhe të disa fshatrave përreth si: Maminas, Vlashaj, Karrec, Vorë etj. Iniciatori dhe mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte Ramazan Sadik Subashi. Në kujtimet e tij ai dëshmonte për gëzimin e asaj dite. "Na dukej vetja sikur fluturonim edhe pse për lokal shkolle shërbente një kasolle e mbuluar me kashtë. E nisëm me 4 nxënës dhe shumë shpejt u bënë 35". Në vitin shkollor 1917-1918, me kontributin vullnetar të banorëve, u ndërtua godina e parë shkollore në historinë e trevës së Vorës. Kjo ndikoi në shtimin e numrit të nxënësve edhe nga

fshatrat përreth. Në vitin 1923 për shkollën fillore të Marikajt vijnë vlerësimet e para. Në raportin mbi gjendjen aktuale të shkollave të datës 30/6/1923, thuhet: "...shkolla Marikaj është e re, e ndërtuar dhe e plotësuar me të gjitha orenditë e me bazën materiale të nevojshme. Gjithashtu mësuesi është tepër i afte dhe i kujdesshëm. Vendi i ndërtesës është shumë i mirë pasi i shërben edhe fshatrave përreth". E ndërsa në shkollën e Marikajt vazhdonte mësimi rregullisht, banorët e Vorës vazhdonin përpjekjet me këmbëngulje për hapjen e shkollës së tyre. Viti shkollor 1930-1931 shënon hapjen më së fundi të shkollës fillore në Vorë, por njëkohësisht shënon edhe mbylljen e shkollës fillore në Marikaj dhe transferimin e mësuesit Ramazan Subashi në shkollën e Vorës duke u bërë kështu edhe mësuesi i parë i kësaj shkolle. Mbyllja e shkollës fillore në Marikaj dhe transferimi i mësuesit nga fshati Marikaj i nënprefekturës Shijak në komunën Vorë të nënprefekturës Tiranë për mungesë fondesh ishte një justifikim. Arsyet ishin të tjera. Në vitin 1923, Ramazan Subashi, ashtu si edhe shumë mësues të tjerë me pikëpamje demokratike dhe përparimtare, ishte bërë anëtar i shoqërisë "Bashkimi", në nëndegën e Shijakut. Shoqëria "Bashkimi" nuk shihej me sy të mirë nga qeveria e asaj kohe, pasi pikëpamjet e saj binin ndesh me politikën qeverisëse. Më 20 maj 1925, Ministria e Brendshme, duke ndjekur veprimtarinë e kësaj shoqërie, në një shkresë të saj pasqyron emrat e 18 anëtarëve të degës së Shijakut. Prej tyre, 8 anëtarë ishin mësues dhe njëri prej tyre ishte Ramazan Subashi. Anëtarët e kësaj shoqërieurvejoheshin dhe ndiqeshin si kundërshtarë politikë të qeverisë së asaj kohe. Një tjetër arsye e këtyre përndjekjeve për Ramazan Subashin ishte se në votimet e vitit 1923, ai u zgjodh zgjedhës i dytë për tërë zonën e tij ku ai përfaqësoi shoqërinë "Bashkimi". Për këto arsye atë kërkojnë ta transferojnë në zonë të thella të Tiranës, por sërish këmbëngulja e banorëve të zonës bëri që ai të mos transferohej në zonat e thella, por të shkonte si mësues në fshatin Kashar duke u bërë kështu mësuesi i parë edhe për këtë fshat. Aty qëndroi për një periudhë të shkurtër, pasi këmbëngulja e banorëve të Vorës bëri që ai të kthehet përsëri si mësues në Vorë. Si ndërtesë e shkollës së Vorës në atë kohë shërbente hani i fisit Picari dhe kjo shkollë i shërbente një komuniteti shumë të gjerë të fshatrave Vorë, Muçaj, Picar, Gjokaj, Bërxull, Mazrek dhe Fushë-Prezë. Banorët e zonës së Vorës dhe nxënësit e tij të asaj kohë ruajnë kujtimet më të mira për mësuesin e parë të tyre si mësues i rregullt, i ditur, kërkues dhe shumë i rreptë për përvetësimin e mësimin sa ata shprehen se ai nuk dilte nga klasa pa u siguruar që edhe nxënësi i

fundit ta kishte përvetësuar mirë mësimin. Mësuesi Ramazani dha mësim në shkollën e Vorës deri në çlirimin e vendit për t'u rikthyer pas një periudhe 15 vjeçare përsëri në fshatin e tij të lindjes, në Marikaj, ku në vitin 1948-1949, për arsye të rritjes së numrit të nxënësve shkolla bëhet me dy mësues. Ai punon bashkë me djalin e tij, Seit Subashin, i cili në atë kohë kishte përfunduar shkollën normale të Elbasanit dhe ishte normalisti i parë i kësaj treve. Pas një pune të gjatë në përgatitjen e brezave të tërë të nxënësve në tërë zonën e Vorës, Ramazani del në pension në vitin 1951, por asnjëherë nuk u shkëput nga shkolla dhe arsimit. Atë e shikoje gjithmonë pranë mësuesve më të rinj dhe nxënësve, duke ndjekur nga afër mbarëvajtjen e shkollës dhe duke dhënë gjithmonë eksperiencën e pakursyer të tij. Atë e shikoje gjithmonë në takime dhe përvjetorë të ndryshëm që organizonte shkolla. Për punën e përkushtuar 35 vjeçare në edukimin dhe arsimimin e brezave, në vitin 1966, në kuadër të 50 vjetorit të hapjes së shkollës Marikaj, ai dekorohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Urdhrin "Naim Frashëri i klasit III". Në vitin 2002, pas një vonese të gjatë emri i mësuesit veteran, i banorit të parë të kësaj treve që mësoi të shkruajë dhe lexojë shqip dhe këtë u transmetonte edhe qindra brezave të tjerë, u përjetësua duke i vënë shkollës 9 vjeçare emrin Ramazan Subashi. Figura e këtij personaliteti rrezatoi për vite të tëra dituri, patriotizëm dhe fisnikëri.

Në drejtimin e dytë, pra në aspektin e një prijësi dhe predikuesi të fesë islame shikojmë se ai ishte një mësues dhe edukator i shkëlqyer, i brumosur në besimin tek Allahu i Madhëruar dhe gjithmonë shkolla, mësimi dhe shkenca gërshetoheshin me mësimet morale të fesë islame dhe Fjalën e Allahut. Për një kohë të caktuar ai shërbeu si mësues por edhe si imam në fshatin Marikaj. Figura e Ramazan Subashit ndërmjet mësuesit dhe predikuesit islam shikohet dhe në drejtimin që ai u dha dy djemve të tij, ku djali i tij i madh, Seiti, mori drejtimin e arsimit si normalisti i parë i zonës, ndërsa djali tjetër, Fadili, mori drejtimin e predikuesit islam duke mbaruar Medresenë e Tiranës. Vetë Ramazan Subashi, krahas mësimave të para të gjuhës shqipe mori edhe mësimet e para fetare islame nga mësuesi i tij i parë Hasan Vogli, që ishte dhe një predikues i rregullt i fesë islame. Njëkohësisht ai mësimet fetare i mori dhe në gjimnazin Turk të asaj kohe. Për të rritur në një shkollë më të lartë njohuritë e tij mbi fenë islame, ai mbaron studimet edhe në Medresenë e Shijakut, gjë që vërtetohet nga dokumenti i lëshuar nga kjo shkollë me datë 17/4/1937. Megjithëse shërbente si imam në xhaminë e fshatit Marikaj, aktiviteti i tij shtrihej në tërë zonën e Vorës dhe Maminasit, ku ligjëratat

e tij mjaft tërheqëse mbi moralin e fesë islame bëheshin pjesë çdo të premteje apo çdo familjeje në raste gëzimi e hidhërimi. Ai shpesh shikohej edhe në shoqërinë e personaliteteve islame të asaj kohe si: H. I. Dalliu, H. Mahmut Dashi, Haki Sharofi, H. Ismet Dibra etj., ku bashkëbisedonin mbi tema të ndryshme rreth fesë islame. Edhe pas daljes në pension atë e gjejmë përsëri imam në Marikaj me dekret të Komunitetit Mysliman, nr. 35 datë 22/5/1956. Me indinjatë të thellë do ta përjetonte ligjin famëkeq të vitit 1967, sidomos prishjen e xhamisë në fshatin Marikaj, ku kishte shërbyer dhe ligjëruar për vite të tëra vlerat morale të fesë islame. Megjithëse në moshë të thyer ai do të gjente ngushëllimin me bashkëfshatarët e tij me biseda rreth fesë islame dhe duke kryer megjithëse në fshehtësi ritualet e festave islame si dhe namazin e teravive gjatë muajit të Ramazanit.

Drejtimi i tretë mbi jetën e Ramazan Subashit do të jetë në aspektin atdhetar e patriotik, human dhe njerëzor. Që në rininë e hershme ai ishte brumosur me idetë atdhetare të rilindësve dhe më vonë me moralin e lartë të fesë islame. Këto veti ai do t'i pasqyronte gjithmonë në jetën e tij në ndihmën që i jepte bashkëfshatarëve të tij kur ai i gjendej gjithmonë pranë në hallet dhe vështirësitë e tyre. Ai disa herë me personalitetin e tij arriti të shpëtonte fshatin dhe fshatarët e tij nga valët e egra të luftës, pasi ai gëzonte respektin e qeveritarëve të Shijakut dhe të familjes Picari në Vorë, prej të cilëve varej fshati Marikaj. Edhe pas çlirimittë vendit aktiviteti i Ramazan Subashit ishte gjithmonë në rritje, me iniciativën dhe këmbënguljen e tij u përgatitën breza të tërë mësuesish dhe kuadro të tjerë nga fshati Marikaj, ku duke filluar nga dy djemtë e tij Seit dhe Fadil Subashi dhe një numër i madh nipërish dhe mbesash që mbajnë mbiemrin Subashi, shërbyen në armatën e mësimdhënies duke ndjekur rrugën e mësuesit arsimdashës. Vlerësimi më i madh për mësuesin, edukatorin, predikuesin islam dhe njeriun human do të vinte vetëm pas rënies së sistemit komunist, ku shkollës 9-vjeçare në Marikaj i vendoset emri Ramazan Subashi dhe figura e tij mori një vlerësim nëpër gazeta dhe shkrime të ndryshme. Me këtë rast vlen të përmendim znj. Fatrije Alimehmeti Daja, e cila në librin mbi patriotin Hasan Vogli, i jep një vend të rëndësishëm figurës së nxënësit të tij Ramazan Subashi. Po kështu në librin e z. Xhemal Balla, "Personalitete të Kulturës Fetare e Atdhetare në Tiranë", një vend të veçantë si mësues dhe prijës islam do të ketë dhe Ramazan Subashi. Gjithashtu edhe në librat e ish-nxënësve të tij Xheladin Shaqir Subashi, mbi fshatin Marikaj dhe Arsimit në Trevën e Vorës një vend mjaft të rëndësishëm ka merituar figura e mësuesit Ramazan Subashi.



30

këshilla për

30 ditët e Ramazanit

1. Të shtrojmë iftare për të afërmit dhe miqtë tanë.
2. Të presim me lutje dhe dua kohën e iftarit.
3. Nëse është e mundur të realizojmë Umre në Ramazan.
4. Të mësojmë ta lexojmë Kuranin nëse nuk dimë, e nëse dimë të përpiqemi ta lexojmë me texhvid (me rregulla).
5. Le të japim çdo ditë nga pak lëmoshë.
6. Të falim namazet me xhemat.
7. Të marrim pjesë në biseda dhe programe fetare.
8. Në shtëpi apo vendin e punës të vendosim kuti të lëmoshës për njerëzit në nevojë.
9. Të shpërndajmë ndihma për të varfrit.
10. Të vizitojmë personat në nevojë.
11. Të përpiqemi të heqim dorë nga veset e këqija.
12. Të vlerësojmë netët e Ramazanit duke fjetur më pak.
13. Të falim namaz nate apo tehexhjud.
14. Të agjërojmë me duart, gjuhën, veshët dhe sytë tanë.
15. Të mësojmë siç duhet rregullat e agjërit.
16. Të bëjmë itikaf në 10 ditët e fundit.
17. Të forcojmë lidhjet me fqinjët dhe miqtë.
18. Të shpërndajmë dhurata si libra apo broshura informuese rreth Ramazanit.
19. Të shtojmë interesin e fëmijëve ndaj Kuranit.
20. Të lexojmë përkthimin e Kuranit për ta kuptuar më mirë.
21. Të lexojmë gjithë Kuranin gjatë muajit të Ramazanit.
22. Të marrim pjesë në mukabele (lexim Kuranit).
23. Të ngrihem rregullisht për syfyr.
24. Të mos nënvlerësojmë namazet e teravive.
25. Të mos bëjmë shpenzime të tepërta për sofrën e syfyrin apo iftarin.
26. T'i falim namazet në kohën e tyre.
27. Të mësojmë fëmijët me namazin dhe xhaminë.
28. Të përgatitim konkurse për njohuritë fetare të fëmijëve.
29. Të ndajmë kohë për fëmijët tanë.
30. Të organizojmë gara apo konkurse familjare.



AGJËRIMI DHE PËRFITIMET E TIJ SHËNDETËSORE

Si fillon të ndryshojë trupi i njeriut kur ai është i privuar sistematikisht nga ushqimi dhe uji? A ka dobi biologjike që shoqërojnë ato shpirtërore? Ja disa përgjigje...

Shëndeti i zemrës dhe parandalimi i diabetit

Ekspertët kanë zbuluar se kufizimi i marrjes së ushqimit gjatë ditës mund të ndihmojë në parandalimin e problemeve shëndetësore si kolesteroli i lartë, sëmundjet e zemrës dhe obeziteti, si dhe të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien mendore. Një studim i vitit 2008 i kryer në Utah zbuloi se njerëzit që agjërojnë rregullisht ulin rrezikun për t'u prekur nga sëmundjet koronare. Në vitin 2014, një studim pauses zbuloi se agjërimi nxit ndryshime metabolike dhe ul nivelet e kolesterolit "të keq", që nga ana tjetër mund të zvogëlojë mundësinë e sëmundjeve të zemrës deri në 58%. Ai studim tregoi gjithashtu një ulje të nivelit të sheqerit në gjak tek njerëzit që agjërojnë. Abstenimi nga ushqimi për periudha të gjata kohore mund të bëjë që trupi të përdorë energji nga burime të ndryshme. Ndërsa energjia zakonisht merret nga glukozja e ruajtur në mëlçi, agjërimi me ndërprerje ndryshon metabolizmin në mënyrë që në vend të saj të përdoren ketonet e ardhura nga djegia e yndyrnave. Ky proces, i njohur si ketogjenezë, dihet se ka një gamë të gjerë përfitimesh, duke përfshirë shtypjen e inflamacionit dhe përmirësimin e përgjigjes së trupit ndaj stresit.

Pastrim i toksive dhe qelizave të demtuara

Duke mos konsumuar asnjë ushqim, trupi ynë është në gjendje të përqendrohet në largimin e toksinave,

pasi ne i japim pushim sistemit tretës. Agjërimi lejon që zorrët të pastrohen dhe të forcojnë mukozat e saj. Ai mund të stimulojë gjithashtu një proces të quajtur autofagi, ku qelizat e demtuara vetë shkaterrohen dhe largojnë grimcat e demtuara dhe të rrezikshme.

Shëndeti mendor

Agjërimi mund të jetë i detyrueshëm fetarisht, por traditat sociale dhe bashkësore që shoqërojnë agjërimin sjellin përfitim. Gjatë Ramazanit, familjet ulen për të çelur agjërimin e tyre çdo natë sëbashku. Ata vizitojnë shtëpitë e të afërmeve dhe miqve për ritualin e njohur si iftar. Aspekti i përbashkët i një agjërimi të tillë ka treguar se ndikon në shëndetin mendor të njerëzve në një mënyrë pozitive. Angazhimi me agjërim mund t'i afrojë familjet dhe grupet shoqërore, shpesh ndihmon njerëzit që vuajnë nga depresioni dhe vetmia duke i siguruar ata se nuk janë vetëm. Shkencëtarët kanë studiuar gjithashtu lidhjen midis dietës dhe mirëqenies mendore. Agjërimi mund të çojë në lirimimin e BDNF (faktori neurotrofik i rrjedhur nga truri) në tru. Ky faktor mbron qelizat e trurit dhe mund të zvogëlojë depresionin dhe ankthin, si dhe rrezikun e zhvillimit të demencës.

Ndërprerja e varësisë

Agjërimi, i jep trupit kohë për të ndaluar dhe rinisur. Kjo pauzë, shkëputja nga rutinat ditore mund të ndihmojë në thyerjen e zakoneve ushqimore si varësia ndaj sheqerit, kafeinës ose duhanit.



Fëmijët

**shkruajnë dhe këndojnë
për muajin e bekuar të
Ramazanit**

Merjemi, vajza e Omerit, mikut tim të besimit dhe të halleve, sapo i mbushi 12 vite të jetës së saj. Për këtë vit, ajo ka vendosur ta agjërojë të plotë muajin e bekuar të Ramazanit. Edhe në vitet e tjera, vajza ka agjëruar pjesën më të madhe të ditëve, me sa ka pasur mundësi; madje vitin e kaluar ajo pothuajse ia mbërriti, por javën e fundit u sëmur, dhe...

Merjemi është nxënëse e shkëlqyer e Medresesë dhe midis të tjerave, i pëlqen shumë letërsia dhe artet. Ajo lexon shumë dhe shkruan nga pak. Me shumë dëshirë e lexon revistën "Drita Islame", veçanërisht pëlqen rubrikën "Hapësirë fëmijore", por edhe shkrime të tjera interesante. Teksa bisedojmë, vajza më tregon një shkrim të dy viteve më parë, ku janë edhe vargjet, të cilat i pëlqejnë shumë:

Ramazan, bekuar qofsh,
Për çdo vit më thua: Rrofsh!

Ajo i përsërit shpesh këto vargje dhe shton pas tyre me gëzim vargje të tjera të vetat, po aq të bukura dhe kuptimplote, të cilat burojnë nga zemra e saj e gëzuar, e mbushur me dashuri dhe shpresë:

Del blerim nga toka,
Vjen nga qielli dritë,
Na erdhë bekimi,
E presim si sytë.

Teksa vajza reciton vargjet e shkruara prej saj, na afrohet vëllai i vogël i Merjemit dhe thotë:

- Edhe unë e kam emrin Bekim!
- Ne qeshim së bashku dhe e urojmë nga zemra këtë fëmijë të mbarë: Zoti të bekoftë!

Merjemi ka vendosur që iftarin e parë ta çelë me shoqet dhe shokët e klasës. Ata janë nga lagjet përreth, por ka edhe nga pak më larg si Selita, Yzberishti...

Ja si i shkruan Merjemit shoqja e saj më e ngushtë, Esmaja, e cila banon në një shtëpi të bukur në hyrje të Selitës:

Nga Selita do të çojmë,
Ujë të pastër nga burimi,
Pas agjërimit të urojmë;

Veç për Zotin, adhurimil..

Kurse nga Yzberishti fëmijët dërgojnë këngë të bukura dhe vargje interesante. Ja si shkruan njëri prej tyre, i cili i ka prindërit tregtarë të miellit dhe prodhues të bukës, pastave dhe ëmbëlsirave:

Do të sjell nga Yzberishti,
Miell të bardhë sa më s'ka,
Të gatujmë për iftarin,
Petanikë e bakllaval..

Merjemi më tregon me gëzim edhe një vjershë, që e ka shkruar nëna e saj, mësuese, e cila dëshiron t'u dhurojë për iftar dhe syfyri agjëruësve, qershi të freskëta të stinës:

Nga Përmeti e Çamëria,
Nga Kosova e Dardanit;
Vijnë arkat me qershia,
Me urimet dalë prej zemre:
Ju bekoftë Perëndia,
Agjërues të Ramazanit!..

Urimet, vjershat dhe këngët s'kanë të mbaruar, sepse çdo ditë e muajit të bekuar të Ramazanit është ditë feste e gëzimi, sakrificë dhe shpërblimi.

Po Merjemi dëshiron ta kënaqë edhe gjyshen e saj Mynevere, e cila për shumë e shumë vite e ka çelur iftarin me grurë të pastër të tokës sonë dhe me ujë burimi nga gurrat tona të dëlira. Gruri këto ditë është i njomë dhe gjyshi do ta sjellë atë nga fusha e Korçës ose nga fusha e Myzeqesë. Vajza ka shkruar në fletore:

Kur gjyshi më solli si dhuratë,
Një tufëz me kalling nga ara,
Zotit iu luta dhe thashë:
Paskam nurin tënd përpara!..

Dhe kështu vjershat dhe këngët e fëmijëve s'kanë fund, në të gjitha ditët e këtij muaji të begatë.

Merjemi i mbledh me kujdes këto frymëzime dhe i shkruan në një fletore të re, për t'i pasur kujtim dhe për t'i përmendur e shumuar në vitet e tjera që do të vijnë.



SADAKAJA E FITRIT DHE ZEKATI / 2023

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është organi zyrtar i përfaqësimit të myslimanëve në Shqipëri, dhe si i tillë, mbledh dhe shpërndan me përgjegjësi të plotë amanetin e besimtarëve dhe çdo qytetari.

• *Sadakaja e Fitrut do të jetë në vlerën 400-Lek për frymë*

• *Vlera e përlllogaritur monetare (Nisabi) mbi të cilën lind detyrimi për të dhënë Zekatin e këtij viti është 570.000-Lek*

